



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 8.11.2023, ora 13:30

Drejton mbledhjen (online)

Nasip Naço - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutim me Ministrinë e Mbrojtjes në lidhje me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Antoneta Dhima, Bardhyl Kollçaku, Toni Gogu, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Paulin Sterkaj, Luan Duzha, Ilirian Pendavinji, Kasem Mahmutaj, Bujar Çela, Klevis Xhoxhi dhe Arkend Balla.

Mungojnë:

Agron Çela, Flamur Noka, Ervin Salianji, Enkelejd Alibeaj, Lindita Metaliaj, Isuf Çelaj, Ferdinand Xhaferraj, Asllan Dogjani, Monika Kryemadhi dhe Lefter Gështenja.

Të ftuar:

Niko Peleshi - ministër i Mbrojtjes

Gelardina Prodani - sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes

Kolonel Ardian Lilo - drejtor i J5-s

Nuri Laknori - drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes

Gentian Opre - drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahim i - drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço - ... zoti Niko Peleshi.

Faleminderit, zoti Peleshi!

Po ashtu, të ftuar janë: zonja Geraldina Prodani, sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, kolonel Ardian Lilo, drejtor i J5-s, si dhe zoti Nuri Laknori, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes.

Faleminderit!

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të përfaqësohet nga Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe zoti Fran Brahimi, drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit.

Faleminderit!

Për arsye objektive, ky buxhet do të diskutohet *online*.

Fjala është për ju, zoti Peleshi.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Do të mundohem të jem sa më sintetik dhe më pas do ta zhvilloj më tej diskutimin edhe me pyetjet tuaja. Gjithsesi, do të jap të dhënat e plota të projektbuxhetit të vitit 2024, i cili, dua ta them që në fillim, garanton mbështetje të plotë financiare për zbatimin e reformave të reja në sektorë kyç të ekonomisë. Natyrisht, mbrojtja, ashtu si të gjithë sektorët e tjerë, ka nevoja shumë herë më tepër sesa mundësitë. Jo vetëm në një vend në zhvillim si Shqipëria, por edhe në vende më të zhvilluara gjithmonë nevojat janë më të mëdha sesa mundësitë financiare. Por ky është një vit rekord, jo vetëm sepse çdo buxhet është më i madh sesa buxheti paraardhës, por edhe sepse në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes ne kemi një kapërcim goxha të madh (siç do ta shtjelloj edhe më poshtë) krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar, edhe për një arsye tjetër, që lidhet me angazhimin tonë në NATO, për të shkuar në 2% të GDP-së në vitin 2024. Jo të gjitha vendet e NATO-s e kanë ndërmarrë këtë angazhim. Shqipëria është një prej vendeve të angazhuara për të arritur 2-përqindëshin. Ne e themi sot me shumë kënaqësi dhe me krenari, që ky projektbuxhet, që po ju paraqesim juve, zë 2%, madje diçka më tepër, të PBB-së, pra përmbush dhe angazhimin tonë në NATO.

Hartimi i projektbuxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për periudhën afatmesme 2024-2026 është bërë në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, të udhëzimit nr.22, datë 02.07.2023, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, si dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për trajtimin ekonomik dhe financiar të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes. Pra, përmenda bazën ligjore. Kërkesat reflektojnë, gjithashtu, nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura për përmbushjen e misionit kushtetues dhe të detyrimeve ligjore, bazuar në kërkesat e programeve të mbrojtjes, listën e integruar të prioritetëve për vitet 2024-2029, nevojat për përbalimin e rreziqeve dhe kërcënimeve që paraqet për sigurinë dhe mbrojtjen mjedisi i sotëm i sigurisë, si dhe detyrimet në raport me NATO-n, me kapitullin 31 të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes, por edhe angazhimet e tjera ndërkombëtare.

Ne do ta strukturojmë sot prezantimin në tri grupe, le të themi: realizimi i pritshëm i buxhetit të vitit 2023 (do të japim disa të dhëna për këtë), më pas do të flasim për prioritetet e projektbuxhetit të vitit 2024, si dhe disa konkluzione përfundimtare.

Para se të flasim konkretisht për buxhetin, do të doja të risillja edhe një herë në vëmendjen tuaj atë që të gjithë e dimë, pra rëndësinë që kanë marrë siguria, mbrojtja, paqja, stabiliteti në kohën e sotme, pas agresionit rus në Ukrainë, por edhe konflikteve të tjerave të ndezura së fundmi, siç është ai më kritik, pas sulmit terrorist të Hamasit ndaj Izraelit, një konflikt i cili ka potencialin të zgjerohet edhe në rajon dhe të ndikojë, gjithashtu, në ekuilibrat apo në situatën e sigurisë më gjerë se në rajon. Ballkani Perëndimor ka konfliktet e veta të fjetura, të cilat, natyrisht, në këtë situatë të përgjithshme të sigurisë së tronditur në botë, zgjohen. Duhet thënë që ne jemi dyfish të shqetësuar dhe të interesuar për një nga dy vatrat kryesore të konflikteve të mundshme, siç është Veriu i Kosovës, në të cilin kemi pasur dhe tensione së fundmi dhe, pa dyshim, duke qenë se është shteti i dytë shqiptar në rajon, ne e kemi prioritetin e prioritetëve. Në të gjitha diskutimet, në strategjinë tonë dhe kudo ku marrim pjesë, në forumet ndërkombëtare, në nismat rajonale, në samitet e NATO-s, Kosova për ne është dhe do të mbetet prioritet i prioritetëve. Ndaj, në kuadrin e sigurisë së përgjithshme pa dyshim që edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor, një rajon i brishtë, është i prekur dhe i kërcënuar nga këto rreziqe.

Aleanca jonë e NATO-s ka dy kërcënime kryesore të njohura: kërcënimin rus, dhe terrorizimin. Ato vijojnë të mbeten aktuale dhe sfidat e mjedisit të sigurisë, detyrimet që kemi për zhvillimin e kapaciteteve në kuadër të mbrojtjes kolektive të aleancës dhe shkurajimit, pritet të shtohen pikërisht për shkak të këtyre kërcënimeve dhe për sa shpjegova edhe më lart.

Po përmend vetëm dy risi: në vitin e ardhshëm do të fillojë rritja e kapaciteteve të mbrojtjes kundërajrore dhe sistemi antidron, për mbrojtjen e popullsisë, të infrastrukturës kritike kombëtare ushtarake, por jo vetëm, sepse, natyrisht, edhe cenimi i infrastrukturës kritike joushtarake kombëtare dhe civile është cenim i sigurisë kombëtare. Ndaj ky sistem antidron është duke u projektuar edhe në bashkëpunim me institucionet e tjera të sigurisë ose që kanë nën administrim infrastruktura kritike, dhe do të jetë i integruar. Kjo është një risi, sepse nuk e kemi pasur më parë, do ta zhvillojmë duke filluar nga ky vit. Pra, synojmë të kemi një mbrojtje sa më të plotë, integrale, të infrastrukturës kritike ushtarake dhe civile në vendin tonë. E kam fjalën për sistemin antidron, ndërsa ajo që përmenda të parën, mbrojtja kundërajrore, vjen si një risi në kohën e sotme. Natyrisht, Shqipëria është një vend i NATO-s, është një vend i sigurt, por kemi edhe kërcënime, ku disa prej tyre janë tradicionale dhe disa janë edhe të reja, të shtuara. Për shembull, pas sulmit kibernetik të orkestruar nga Irani, gjë që solli edhe prishjen e marrëdhënieve diplomatike me Iranin, pa dyshim që është shtuar edhe një kërcënim i ri për Shqipërinë, pra kërcënimi kibernetik dhe jo vetëm, sepse kërcënimet janë të ndërlidhura, nuk mund t'i ndash qartësisht. Ndaj dhe mbrojtja kundërajrore për ne është një risi, që është ngjitur shpejt në vendin e parë të prioriteteve. Duke filluar nga ky vit, duhet ta them, në bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë amerikanë kemi filluar plotësimin e sistemit të mbrojtjes kundërajrore, me burime nga ky buxhet, të mjaftueshme për atë që kemi projektuar, por edhe me kontribute dhe donacione nga partnerët strategjikë SHBA-të.

Ky është viti kur disa dokumente shumë të rëndësishme të sigurisë do të marrin jetë. E para, strategjia e re e sigurisë kombëtare, e cila është në segmentin e fundit të hartimit dhe miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe më pas menjëherë në parlament. Kjo strategji e re do t'u hapë rrugë derivateve të veta, një prej tyre është strategjia ushtarake, por edhe plani afatgjatë i zhvillimit të Forcave të Armatosura, dokumente këto që miratohen edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe rishikimi strategjik i mbrojtjes. Është momenti kur na duhet të bëjmë një ridiskusim, një rishikim të kërcënimeve. E shpjegova pak më lart, shkurtimisht, që kërcënimet janë dinamike, ndryshojnë në kohën e sotme, disa të vjetra kanë ngritur krye dhe disa të tjera, të pallogaritura më parë për ne, janë shfaqur. Ndaj të gjitha këto duhet të reflektohen në dokumentet tona strategjike dhe më pas

të zbërthehen në plane të mbrojtjes dhe në paketën tonë të investimeve apo të modernizimit. Siguria e vendit tonë lidhet dhe është pjesë integrale e mbrojtjes kolektive të Aleancës dhe në planin e modernizimit do të konsiderojmë ndërtimin e kapaciteteve me përdorim të dyfishtë dhe të shumëfishtë për NATO-n, për Bashkimin Europian, për vendin, por, nëse duhet, edhe për aleancat strategjike. Pra, ne punojmë për mbrojtjen kolektive, e kam fjalën për ngritjen e kapaciteteve në kuadrin e mbrojtjes kolektive të aleancës sonë në NATO, por edhe për mbrojtjen tonë kombëtare. Ky buxhet i furnizon të dyja këto korsi.

Sa i përket performancës së vitit 2023, dua të nënvizoj se programi në fushën e mbrojtjes i ka përmbushur objektivat dhe ka vijuar reformat për transformimin e mëtejshëm, të shpejtë të Forcave tona të Armatosura, për krijimin e kapaciteteve të reja për përballimin e sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe për dinjitetin dhe figurën e ushtarakut, duke përmirësuar atë që ne e quajmë “paketa sociale e ushtarakëve dhe e ish-ushtarakëve tanë”, që lidhet me kushtet e jetesës, të shërbimit dhe me shërbimet plotësuese sociale për këtë kategori shoqërore.

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2023, siç e thashë, i ka shërbyer edhe përmbushjes së detyrimeve ndaj NATO-s nëpërmjet modernizimit të kapaciteteve ekzistuese dhe krijimit të kapaciteteve të reja, që lidhen me Grup-batalionin e Këmbëorisë së Lehtë, me Forcat Speciale, me sistemet e komunikimit dhe informacionit, si dhe me kapacitetet e mbrojtjes kibernetike. Siç e dimë, ne kemi një listë me objektivat e kapaciteteve të angazhuara në raport me aleancën tonë në NATO, tek të cilat jemi angazhuar të investojmë, t'i plotësojmë dhe t'i pasurojmë.

Viti 2023 ka qenë një kontribut i rëndësishëm në drejtim të plotësimit të këtyre angazhimeve, por më e rëndësishmja, strategjiksht dhe politikisht, është se buxheti i mbrojtjes i vitit 2023 i ka hapur rrugë plotësimit të zotimit të qeverisë për arritjen e pragut 2% të PBB-së në vitin e ardhshëm. Viti i kaluar ka pasur gjithashtu një rritje. 1,81% ka qenë buxheti i vitit 2023 në raport me GDP-në, pra nga 1,64-1,65% vitin e kaluar. Në mënyrë graduale, kemi krijuar mundësinë për të shkuar në 2% këtë vit.

Mbrojtja kibernetike, siç e thashë, është një nga fushat që, pas sulmit kibernetik iranian, është bërë edhe më e rëndësishme, është bërë prioritet. Ndaj ne kemi vijuar, në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët tanë strategjikë, SHBA-të, projektin e filluar prej pak vitesh, prej 2-3 vjetësh, të ndërtimit të Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike, pranë Njësisë Ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike në Ministrinë e Mbrojtjes. Kjo qendër ka përfunduar. Pas pak ditësh ne do të kemi

edhe mundësinë t'ju ftojme ju, Komisionin e Sigurisë, për të marrë pjesë, le të themi, në një ceremoni përrurimi të kësaj qendre.

Në prioritetet e vitit aktual kanë qenë edhe zhvillimi, rritja e kapaciteteve dhe e aftësive operacionale të Forcave të Armatosura, me fokus konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Grup-batalionit të Këmbësisë së Lehtë dhe Forcave Speciale, duke vijuar me kompletimin me armatime, me municion, me pajisje komunikimi dhe me mjete taktike të blinduara, krahas rritjes së kapaciteteve të mbështetjes me zjarr. Sidoqoftë, ky ngelet një proces i përhershëm, i cili do të vijojë, pra nuk e kemi mbyllur këtu. Të gjithë këta zëra që përmenda, edhe në buxhetin e vitit 2024, por edhe në buxhetin afatmesëm e më tej, do të jenë në prioritetet tona, sepse, siç e thashë, janë edhe objektiva të kapaciteteve të NATO-s.

Edukimi profesional ushtarak, Akademia e Forcave të Armatosura ngelet një prioritet i rëndësishëm për të rritur kapacitetet njerëzore, cilësisht jo vetëm në numër, por edhe në cilësi, ndaj edhe kemi revolucionarizuar arsimin profesional ushtarak, duke marrë modelin më të mirë. Ky është viti i parë, ku kemi kaluar në ciklin 4-vjeçar më të mirë të arsimimit, sipas akademisë model “*West Point*” të SHBA-së. Nuk kemi vetëm një program studimi, një *bachelor*, siç ka qenë më parë i shkencave ushtarake, por krahas tij kemi edhe dy programe të tjera studimi, IT-i dhe Shkenca Komunikimi, krahas masterit të sigurisë kibernetike, që tani ka hyrë në vitin e tretë dhe është një kontribut i rëndësishëm jo vetëm për strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, por edhe për institucionet e tjera të sigurisë, të cilat investojnë specialistët e tyre në këtë master përmes kualifikimit, që kthehet mbrapsht pastaj në institucionet e tyre dhe i shërbejnë ngritjes të kapaciteteve kibernetike të institucioneve të tjera. Për interes të Ministrisë së Mbrojtjes, kudo që këto kapacitete ngrihen brenda njësisë ushtarake të mbrojtjes kibernetike, në institucione të tjera shtetërore apo qoftë edhe private, i shërbejnë njësoj forcimit të sigurisë kombëtare. Ky është edhe misioni ynë kryesor.

Dua të theksoj se në javën e parë të janarit do të mbërrijnë dy helikopterë *black hawk* nga SHBA-të. Janë një evolucion për forcat tona ajrore, sepse janë kapacitetet më moderne që i bashkëngjiten flotës sonë të helikopterëve. Janë të parët, por jo të fundit, e kemi thënë edhe më parë. Ne po punojmë me aleatët tanë strategjikë për të shtuar flotën, për të arritur brenda një afati të mesëm, jo më larg sesa vitet 2029 apo 2030, për të pasur një flotë prej gjashtë helikopterësh *black hawk*. Tani po punojmë për dy të tjerë, duke bërë saktësimet e nevojshme buxhetore dhe financiare dhe besoj se buxheti i vitit 2024 do të fillojë të alokohet edhe për flotën e helikopterëve

black hawk. Siç e thashë, duam ta pasurojmë këtë flotë dhe do të jetë flota kryesore qendrore e flotës sonë të helikopterëve në Forcat Ajrore.

Një nga zhvillimet e reja të këtij viti që po lëmë pas është edhe kompletimi i laboratorit të analizave dhe të laboratorit dentar. Kemi ngritur dy laboratorë, një klinikë dentare dhe një laborator analizash të dedikuar 100% për ushtarakët dhe ish-ushtarakët, pra që do t'i shërbejnë vetëm pjesës ushtarake, jo pjesës civile. Laboratori është në kompletimet e fundit, pajisjet janë instaluar dhe shumë shpejt do të hapë dyert për t'u shërbyer ushtarakëve dhe ish-ushtarakëve tanë. Natyrisht, shpenzimet do të jenë të gjitha të mbuluara nga Ministria e Mbrojtjes. Ushtarakët, pa dyshim, janë edhe civilë dhe kanë nevojë për të bërë *check up-in* dhe analiza të tjera, si gjithë të tjerët, por, në ndryshim nga pjesa tjetër e popullsisë, në rastin e misioneve apo operacioneve dhe detyrave të ndryshme, në kuadrin edhe të angazhimeve në NATO, apo misionin në kuadrin e BE-së, UN-it, Kombeve të Bashkuara dhe misione kombëtare, u duhet që herë pas here të kryejnë analiza mjekësore të posaçme. Deri më sot ka munguar kjo infrastrukturë e posaçme siç është ky laborator që do të hapim së shpejti.

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemeve të vëzhgimit të hapësirës ajrore dhe detare, mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve tokësore, detare dhe ajrore, e kemi thënë dhe më parë, nuk kam pse ta fsheh që janë sfida. Në konsultim e sipër, kemi bërë përmirësime të ndjeshme apo kemi inovacion në drejtim të mirëmbajtjes, duke deleguar disa prej procedurave kryesore dhe më të rëndësishme, siç janë mirëmbajtja e helikopterëve *cougar* tek agjencia e NATO-s, gjë që po funksionon shumë mirë edhe në kuptimin e kostove, edhe në kuptimin e shpejtësisë. Dy helikopterë të tjerë *cougar* tani ndodhen pranë kontraktorëve të Agjencisë së Prokurimit të NATO-s në SHBA. E kemi konsoliduar këtë praktikë, tani nuk i kryejmë vetë procedurat, por i kryejmë nëpërmjet tyre, sepse janë procedura të komplikuar, mungojnë operatorët lokalë dhe duhet të jenë patjetër kontrata ndërkombëtare. Kjo është një agjenci që përdoret nga shumë shtete, është agjenci e specializuar dhe ka më shumë kapacitete se ne, nuk kemi përse ta fshehim, për të lidhur kontrata që performojnë më mirë dhe, natyrisht, për t'i menaxhuar ato më mirë sesa kapacitetet tona. Këtë po e bëjmë jo vetëm me helikopterët *cougar*, por edhe me helikopterë të tjerë, të cilët sa më shumë që të pranohen nga OSBE-ja, për ne mundësisht e gjithë flota do të hyjë ciklin e mirëmbajtjes përmes Agjencisë së Prokurimit të NATO-s, duke filluar nga viti i kaluar dhe në vazhdim.

Projekti i projekteve, kryeprojekti, është baza ajrore e Kuçovës. Tani jemi në mbi 95% të punës së kryer, shumë shpejt, le të themi, në javën e parë të janarit, do të jemi gati të bëjmë edhe

përrurimin e bazës ajrore të Kuçovës dhe bërjen e saj operacionale, e cila, siç e dini, është një investim i përbashkët, kryesisht nga fondet e NATO-s, por edhe nga fondet tona kombëtare. Kjo është një bazë taktike ajrore e NATO-s, e para dhe e vetmja në rajonin tonë.

Një projekt tjetër madhor, për të cilin po mundohemi të replikojmë modelin e bazës ajrore të Kuçovës është edhe porti ushtarak i Porto Romanos, si pjesë e projektit të madh të portit të Porto Romanos.

Jemi në fazën që ka përfunduar dizanji. Në këtë buxhet kemi hapur dritaren, zërin e investimeve për këtë port, kuptohet që shpresojmë dhe po shtyjmë përpara që edhe ky port të financohet me modelin e bazës ajrore të Kuçovës, pra kryesisht përqindje dërrmuese nga NATO-ja. Kemi bërë aplikime në strukturat e nevojshme, të cilat marrin kohën e tyre, prandaj dhe e kemi pasur të nevojshme nga pikëpamja e praktikës buxhetore të hapim zërin me një fond modest në buxhetin e këtij viti dhe për të tërhequr atje investime të mundshme potenciale nga NATO-ja dhe partnerë të tjerë për realizimin e këtij porti. Ky port nuk është thjesht një bazë ndihmuese ushtarake detare, por është pika fundore apo e hyrjes dhe e daljes, varet nga i konsiderojmë flukset e Korridorit të 8-të. Korridori i 8-të lidh Durrësin apo Porto Romanon me portin e Varnës në Detin e Zi. Ky korridor nuk është vetëm një korridor konektiviteti, mobiliteti, korridor ekonomik pa dyshim, por është edhe një korridor sigurie, sepse lidh rajonin më të nxehtë të momentit, që është rajoni rreth Detit të Zi, me detin Adriatik, pra, është një dalje drejt detit Adriatik, ashtu siç edhe thashë është një pikë hyrëse, në rast të përdorimit për dislokime të aleatëve, të forcave të NATO-s drejt krahut lindor të NATO-s, që është dhe krahu më i kërcënuar, duke e përdorur këtë port dhe Korridorin e 8-të, për të cilin po punohet nga të tria shtetet tona, nga Bullgaria, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria për të plotësuar me shpejtësi segmentet që i mungojnë këtij korridori. Pra, ky korridor, merr një rëndësi të madhe strategjike, edhe në aspektin e sigurisë. Ndaj porti ushtarak i Porto Romanos, pa dyshim edhe porti i madh, porti komercial i Porto Romanos bëhen dyfish më të rëndësishëm duke i parë edhe në këtë aspekt.

Një tjetër zhvillim, jo vetëm pozitiv, por edhe risi, që filloi në vitin 2023 dhe do të vazhdojë edhe më tej, është zhvillimi i kapaciteteve të sistemeve të fluturimit pa pilot. Nuk i kemi pasur më parë këto kapacitete, janë kapacitete të reja që po i ndërtojnë, në javët në vazhdim do të fillojë dhe trajnimi i personelit për të qenë të gatshëm për operimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Kontrata është lidhur, kanë filluar përgatitjet, është përcaktuar trajneri, personeli dhe do të trajnohen përgjatë

pjesës së ngelur deri sa të hyjmë në vitin tjetër. Ne parashikojmë që në tremujorin e dytë të vitit 2024, kapacitetet e droneve, po e them shkurt, të jenë operacionale.

Do të jetë baza ajrore e Kuçovës vendi ku do të vendoset komanda e tyre, do të jetë një kapacitet jashtëzakonisht i rëndësishëm në kohën e sotme jo vetëm për llogari të sigurisë dhe të mbrojtjes, por edhe në mbështetje të institucioneve të tjera që i kontribuojnë sigurisë dhe mbrojtjes, siç është ligjzbatimi, Ministria e Brendshme, infrastruktura, të cilat do të përdorin imazherinë dhe informacionet e gjeneruara, të prodhuara nga flota jonë e dronëve, shtuar edhe inteligjencën artificiale, me të cilën ato do të jenë të pajisura, do të japin informacione shumë të çmuara.

Ne po e shohim sot me dy satelitët, që u përfolën shumë, por e vërteta është që sot ne kemi një kontratë të lidhur dhe përfitojmë shërbimet e dy satelitëve “Albania 1”, “Albania 2”, të cilat na vlejnë shumë në aspektin e përballimit të emergjencave civile, me informacione të jashtëzakonshme statistikore të përpunuara nga ASI-u, i kemi në dispozicion të AKM-së, por edhe të ministrive të tjera të cilat kanë filluar me shumë efektivitet t’i përdorin imazhet e prodhuara nga dy satelitët.

Folëm për mbrojtjen civile, që ka njohur rritje të konsiderueshme në menaxhimin e situatave të fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut. Këtë vit janë menaxhuar 914 vatra zjarri, pra, afro 1000 vatra zjarri, me angazhimin në total, vetëm për periudhën qershor – tetor të këtij viti 1984 mjete dhe 15 668 forca operacionale.

Natyrisht Forcat e Armatosura janë forca kryesore, por dua të falënderoj këtu edhe të gjithë zjarrfikësit edhe të pushtetit vendor, edhe të strukturave shtetërore, Policinë e Shtetit pa dyshim, që ka qenë model këtë vit dhe për t’u admiruar është shpejtësia me të cilën kanë vepruar, shpejtësia me të cilën kanë identifikuar keqbërësit, i kanë arrestuar dhe çuar përpara ligjit. Presim dhe kam shumë shpresë që organet e zbatimit të ligjit do t’u japin dënimin siç u takon, të merituar në fakt, të gjithë keqbërësve të cilët janë identifikuar dhe arrestuar nga Policia e Shtetit.

Numri i vatrave të zjarrit, për fat të keq, edhe për shkaqe natyrore të ngrohjes globale, vazhdon dhe rritet, por pasojat ulen. Kjo do të thotë se, nga pushteti vendor në pushtetin qendror, i gjithë sistemi i integruar i mbrojtjes civile po funksionon gjithmonë e më mirë. Bashkitë tona po bëhen gjithnjë edhe më të afta jo thjesht më të përgjegjshme, por edhe më të afta për t’u përballur, komunitetet tona po bëhen më të ndërgjegjshme për sinjalizimin e hershëm, që është kaq shumë i rëndësishëm për të eliminuar dhe për të kursyer mund, energji, burime në përballimin e

emergjencave civile që, për fat të keq, ky vend i ka pothuajse gjatë gjithë tinëve të vitit, jemi të ekspozuar ndaj tyre.

Kemi ndërmarrë me sukses dhe vazhdojmë të jemi aktivë në ndihmë të komunitetit. Këtë vit, deri tani, 22 ura “beli” janë ndërtuar nga forcat tona të xhenios dhe janë 86 operacione në mbështetje të popullsisë civile dhe të autoriteteve qendrore dhe lokale.

Në drejtim të infrastrukturës kemi në zbatim projekte të rëndësishme që po ecin mirë, siç është poligoni në Pajet, depo armatime dhe municioni, simulatori i qitjeve me armët e këmbësisë, infrastruktura në bazën ajrore të Kuçovës, e përmenda, ndërtime infrastrukturore në kampusin e Akademisë së Forcave të Armatosura. Po ndërtojmë, përveç do të thosha revolucionarizimit të kurrikulave dhe të pjesës sot, ne po ndërtojmë një infrastrukturë të re moderne, pjesë e një masterplani të madh të CADUS-it, të Akademisë së Forcave të Armatosura, puna ka filluar dhe po vazhdon me intensitet; hangarët e helikopterëve *black hawk* janë, gjithashtu, në ndërtim e sipër; qendra e inovacionit që do t’i hapë dyert pak pas ditësh, si dhe muzeu i Forcave të Armatosura, një pjesë e të cilit tani po merr formë dhe do të përfundojë me shumë gjasa dhe insistim nga ana jonë brenda këtij viti, dhe do t’i hapë dyert.

Inovacioni do të jetë një zhvillim shumë modern, inovacioni nuk ka qenë në fjalorin tonë, t’ju them të vërtetën, por gjithnjë e më shumë edhe në hapësirën e NATO-s flitet për inovacion, për sisteme inovative, për rishikim të sistemeve, për përdorim me shumë eficiencë, por edhe me shumë efektivitet të punimeve për ndërtimin e produkteve të reja, për integrimin e teknologjive të reja, ku inteligjenca artificiale meriton një seancë të posaçme diskutimi edhe në komisionin tuaj, sepse zhvillimet e pritshme janë, nuk dua të përdor fjalën tronditëse se nuk dua të përhap panik, të konsiderueshme dhe do të ndryshojnë shumëçka edhe në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes ashtu si edhe në fushën civile.

Ndaj, edhe ne jemi bërë pjesë e programit të inovacionit të NATO-s, që quhet “DAJANA”, i cili ka një fond që mbështet ndërtimin apo funksionimin e qendrave të testimit, siç quhen, kështu që ne po punojmë që qendrën tonë të inovacionit ta bëjmë pjesë të këtij rrjeti dhe të përfitojmë edhe nga zhvillimet e aleatëve të tjerë dhe të bashkëpunojmë fort me qendrën e inovacionit në vendet e tjera të aleancës.

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes kap vlerën 48,3 miliardë lekë për vitin 2024. Pjesën më të madhe të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes e zë programi “Forcat e luftimit”, i cili mund të konsiderohet si programi mbizotërues, pasi ka pjesën më të madhe të burimeve gjatë gjithë

periudhës dhe arrin në 29% deri 30% të buxhetit për periudhën 2024-2026 për periudhën buxhetore afatmesme vetëm me financim të brendshëm. Pra, vetëm duke përmendur financimin e brendshëm ne jemi në vlerën 30% të totalit të buxhetit me programin që e quajmë “Forcat e luftimit”, por nëse do të fusnim edhe investimet me financim të huaj, shkon në 50% të buxhetit.

Kuptohet që në fushën e mbrojtjes programi më i kushtueshëm në shpenzime do të ishte programi që financon funksionimin e Forcave të Armatosura. Bën sens dhe është e kuptueshme që pjesa më e madhe e buxhetit të shkojë për Forcat e Armatosura, infrastrukturën dhe pajisjet përkatëse.

Programet buxhetore që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me Forcat e Armatosura kanë parashikuar një rritje të konsiderueshme në disa zëra shpenzimesh gjatë kësaj periudhe, në veçanti në rritjen e pagave dhe të shpenzimeve kapitale. Buxheti i vitit 2024 krahasuar me vitin 2023 është rritur me rreth 23%. Pra, nominalisht nga 39 miliardë e 457 milionë lekë shkon në 48 miliardë e 338 milionë lekë. Fondi për investimet është rritur me 48% në total, ku rritja e investimeve me financim të brendshëm është 17%. Buxheti aktual lejon përmbushjen e prioritetëve të Ministrisë së Mbrojtjes si për vijimin e mbështetjes së personelit, modernizimin dhe krijimin e kapaciteteve, zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të punës, të stërvitjes dhe të trajtimit, edhe për arritjen e normave të gatishmërisë dhe operacionalitetin.

Tri shtyllat kryesore të këtij buxheti janë: personeli, mbështetja dhe investimet. Pra, mbështetja e personelit në të gjitha dimensionet, mbështetja logjistike dhe operacionet, si dhe investimet, e kam fjalën për modernizimin dhe infrastrukturën.

Shpenzimet për kategorinë “paga” dhe “sigurime shoqërore” lejojnë përmirësim për trajtimin e personelit. Në përafrimin me sistemin e pagave dhe të strukturave të tjera të sigurisë në vend dhe me vendet e tjera të NATO-s ne do të vijojmë politikën, të cilën e kemi deklaruar edhe më parë, të rritjes së pagave të ushtarakëve për vitin që vjen, nga 7 deri në 22% mbi pagat aktuale. Ju sjell në vëmendje se deri tani kemi bërë dy rritje në harkun e një viti, një herë 30% dhe më pas 7% për të gjithë Forcat e Armatosura nga ushtari bazë e deri te gjeneralët, pra gradat e larta.

Do të vazhdojmë me rishikimet, përfitimet dhe vështirësitë e kushteve të punës. Pra, do të rrisim jo vetëm pagat, por edhe normën e pagesave për vështirësitë e kushteve të punës, si dhe përfitimet e tjera në kuadrin e paketës sociale, politike, e cila do ta ketë efektin financiar vjetor me 1,2 miliardë lekë dhe që do të hyjë në fuqi në 6-mujorin e dytë të vitit 2024.

Përfitimet do të jenë në trajtimin me kredi, i cili është përfitim shtesë në paketën sociale të ushtarakut, e kam fjalën për kredinë e butë për strehim ku ushtarakët, krahas punonjësve të policisë dhe personelit mjekësor, mjekëve, janë përfitues të programit të qeverisë për mbështetjen me kredi të butë për strehim të këtyre kategorive shoqërore.

Te kategoria “shpenzime korrente”, fokusi do të jetë tek orientimi i fondeve në mirëmbajtjen e mjeteve dhe të pajisjeve tokësore, detare dhe ajrore, që ndikojnë drejtpërsëdrejti në realitetin dhe gatishmërinë e forcave, si dhe prokurimin e uniformave, municioneve dhe plotësimin e rezervës materiale të Forcave të Armatosura.

Më konkretisht, prioritetet në këtë kategori janë: kompletimi me uniformë i personelit të Forcave të Armatosura, krahas përmirësimit dhe të trajtimit financiar të tyre, i cili do të ndikojë në rritjen e motivimit, profesionalizmit dhe të dinjitetit të figurës së ushtarakut; blerja e municioneve të nevojshme; mirëmbajtja e mjeteve të blinduara, anijeve, helikopterëve; mirëmbajtja e sistemit të vëzhgimit të hapësirës detare dhe ajrore; trajnimi i pilotëve të forcës ajrore, kontributi në operacione dhe misione ndërkombëtare dhe mbështetja për stërvitjen dhe trajnimin.

Sa u përket misioneve, që sapo jua përmenda, ne jemi aktivë në misionet dhe operacionet e NATO-s, por edhe të Bashkimit Europian, të Kombeve të Bashkuara dhe në misionet multinacionale. Këto kontribute do të vazhdojnë të përfaqësojnë vendin dhe Forcat e Armatosura denjësisht me performancës dhe reputacionin e tyre. Konkretisht, ne kemi 177 trupa që kontribuojnë në operacionet dhe misionet e NATO-s, të BE-së dhe të OKB-së, ku më i rëndësishmi ngelet KFOR-i me 95 veta, por ne do ta rrisim edhe me 2 toga kontributin tonë në KFOR; operacionet e prezencës së përparuar në Bullgari, kemi një togë prej 30 vetash në Bullgari, të cilët janë dislokuar para disa muajsh në kuadrin e përforcimit të krahut Lindor të NATO-s; në Letoni kemi një personel prej 22 ushtarakësh; operacioni në detin Egje, 21 veta; jemi në misionin MMI në Irak me 2 veta, krahas misionit ALTEA të Bashkimit Europian në Bosnjë-Hercegovinë, ku kemi 1 oficer shtabi, por vitin që vjen do ta rrisim kontributin duke dërguar një togë prej 30 efektivësh, si dhe operacioni multinacional në Sinai, për monitorimin e paqes në këtë rajon të rëndësishëm; në Sudanin e Jugut, kemi 4 oficerë, si dhe kemi deklaruar gatishmërinë për të dërguar një kompani në aktivitetet e shkurajimit dhe deterrencës së NATO-s në Rumani.

Vendi ynë do të vazhdojë të jetë kontribues në shtabet ndërkombëtare, kryesisht në strukturën e komandimit ushtarak të NATO-s dhe në strukturën e forcës së NATO-s.

Përcaktimi i nevojave për investime, modernizim dhe infrastrukturë është bërë në interes të modernizimit të kapaciteteve ekzistuese, në zhvillimin e kapaciteteve të reja në mënyrë të veçantë për përmbushjen e objektivave prioritare të kapaciteteve. Po e ritheksoj edhe një herë që është batalioni i lehtë i këmbësisë, kapacitetet stacionare të lëvizshme të komunikimit dhe të informacionit dhe kapacitetet e mbrojtjes kibernetike, si dhe prioritetet kombëtare për periudhën 2024-2026.

Lidhur me projektet e investimeve prioritet u është dhënë projekteve të modernizimit për zhvillimin e kapaciteteve edhe në infrastrukturë, përmirësimin e kushteve të jetesës, së punës, të arsimimit dhe të stërvitjes.

Më konkretisht, së pari, të zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes kundërajrore me bazë në tokë, mishërohen edhe emrat, me aftësi të plota operationale për të mbrojtur infrastrukturën kritike civile dhe ushtarake të Republikës së Shqipërisë si detyrim kombëtar edhe ndaj aleancës së NATO-s në mbështetje të planeve rajone dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike.

E dyta, sisteme stacionare të lëvizshme për zbulimin dhe neutralizimin e objekteve fluturues pa pilot, pra antidron, për mbrojtjen e popullsisë, infrastrukturës kombëtare ushtarake dhe të instalimeve ushtarake, mbrojtjen e reparteve dhe të trupave që dislokohen, si dhe mbështetjen për institucione të tjera të sigurisë në vend.

Së treti, ndërtimi dhe vënia në shfrytëzim i kampusit të ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, duke e transformuar atë në një institucion prestigjioz, i cili do të ofrojë dhe do të zhvillojë programe cilësore studimi në të tre ciklet e studimit.

Së katërti, modernizimi i armatimit me aksesore shtesë dhe kompletim me armatim të standardeve të NATO-s të të gjitha reparteve të forcës tokësore.

Së pesti, kapacitete të çminimit, e thënë thjeshtë EUDE, xheniere dhe me ADM për të siguruar mbështetjen dhe mbrojtjen e trupave në operatione.

Së gjashti, mjetet e transportit dhe ato speciale për mbështetjen e operationeve të Forcave të Armatosura dhe të institucioneve të tjera me mjete transporti me kalueshmëri të lartë, si dhe dislokimin e trupave dhe pjesëmarrjen në operationet brenda dhe jashtë vendit.

Helikopteri *black hawk* UH 60M, është modeli i fundit i helikopterëve *black hawk*, si nevojë për mbështetjen e aktiviteteve të përditshme të Forcave të Armatosura si në rast krize lufte, por edhe si mjet transportues taktik për evakuimin ajroromjekësor, komandim, kontroll dhe

mbështetje për operacionet speciale dhe për operacionet luftarake të kërkim-shpëtimit dhe të emergjencave civile.

Pra, siç jua thashë për ta sqaruar, jemi duke punuar, pra do të marrim dy helikopterë *black hawk* në janar të këtij viti, por po punojmë edhe për të vazhduar investimet në pasurimin dhe plotësimin e flotës së helikopterëve *black hawk*. Pajisjen me një anije me kapacitet luftarak për të kryer jo vetëm detyrat e rojës bregdetare, por edhe ato të mirëfillta luftarake në rast nevojë.

Rritja e fuqisë së zjarrit është e rëndësishme, pasi operacionet e sotme kërkojnë platformë të qëndrueshme, saktësi maksimale dhe shpejtësi të lartë zjarri kombinuar me lëvizshmëri dhe autonomi. Zhvillimi i poligonit kombëtar në Pajet për stërvitjen e njërive dhe të reparteve në ndërtimin e poligoneve të qitjes dhe të përgatitjes taktike. Investimet e brendshme do të ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të paketës së objektivave të kapaciteteve, si dhe të kapaciteteve kombëtare të mbajtjes së niveleve të kërkuara të operacionalitetit dhe të formacioneve luftarake.

Sikundër e theksova edhe më lart, nga analizat e vlerësimit dhe të mbështetjes së programeve në HBA rezulton se forcat e luftimit, po i marr me radhë, në përmbledhje të projekteve të investimeve forcat tokësore, forcat detare dhe forcat ajrore, do të vijojnë investimet në infrastrukturë për të përmirësuar kushtet e punës, të jetesës dhe të stërvitjes.

Për forcat tokësore gjatë vitit 2024 do të investohen 474 milionë lekë, për forcat detare 63,5 milionë lekë, për forcat ajrore 460 milionë lekë, nga të cilat për ndërtimin e parqeve dhe të hangarëve të helikopterëve *black hawk* 200 milionë lekë dhe mjediset për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe testimin e sistemeve ajrore pa pilot, pra droneve, 180 milionë lekë.

Në shtesë, sa më sipër, do të investohet për ndërtimin e godinave për strehimin e ushtarakëve, si dhe poligonin në infrastrukturën stërvitore “Poligoni Pajet”. Do t’jua sqaroj pak më shumë projektin për godinat e strehimit të ushtarakëve. Ne jemi duke rishikuar ligjin për statusin e ushtarakut dhe po hapim një hapësirë për t’i lejuar Ministrisë së Mbrojtjes të investojë në kuadrin e paketës sociale të mbështetjes së ushtarakëve edhe në akomodim. Akomodimi është një ndër pjesët e rëndësishme të mbështetjes sociale. Ne e mbështesim me akomodim një pjesë ende të vogël të ushtarakëve tanë aty ku është e nevojshme, pra kur transferohen me shërbim në rajone të ndryshme të vendit larg vendbanimit të tyre, por tani duam ta adresojmë në mënyrë më të plotë këtë çështje, pra përmes ndryshimit në ligj, nëse projektligji do të marrë miratimin nga Këshilli i Ministrave përmes komisionit tuaj, pastaj edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, ne do të kemi mundësinë që vitin që vjen, të kemi krijuar një hapësirë buxhetore, të fillojmë ndërtimin e disa

apartamenteve sociale për ushtarakët tanë, të cilat natyrisht do të jepen me një qira sociale në formën e pagesës modeste për mirëmbajtjen e tyre, pra jo një qira e mirëfilltë. Ky kontingjent apartamentesh do të jetë gjithmonë në dispozicion të ushtarakëve aktivë, duke u përdorur nga ata për sa kohë që ata do të jenë në kontratë të shërbimit ushtarak aktiv.

Në projektet kryesore të modernizimit do të vijojmë projektin e armatimit të lehtë, municione dhe makineri me 3 miliardë lekë, nga të cilat për pjesët e këmbimit 850 milionë lekë, pajisje individuale të avancuara luftimi për forcat speciale 742 milionë lekë, pajisje dhe pajime individuale dhe kolektive speciale luftimi për kushte ekstreme moti 623,7 milionë lekë, pajisje në forcë tokësore të armatimit individual dhe kolektiv 668 milionë lekë; për forcat detare do të investojmë për pajisjen e anijeve, për përmirësimin e kapaciteteve të operacioneve të kërkimshpëtimit dhe për forcat ajrore në krijimin e kapaciteteve të avionëve pa pilot 2,289 miliardë lekë.

Duke konsideruar nevojën për vijimin e modernizimit dhe zhvillimin e kapaciteteve si ato që janë në kuadër të aleancës, por edhe në zhvillimin e kapaciteteve për interes kombëtar nevojiten natyrisht gjithnjë e më tepër burime financiare. Ky buxhet është një hap progresiv i rëndësishëm, do të thosha galopant, krahasuar me buxhetet e viteve të kaluara, asnjëherë i mjaftueshëm, por këtë herë shumë më i qenësishëm dhe i rëndësishëm për të përmbushur detyrimet tona.

Mbështetja e luftimit është një program tjetër. Investimet do të jenë në infrastrukturë ku përtej përmirësimeve të kushteve të punës, të jetesës dhe të stërvitjes do të investohet edhe në ndërtimin e një objekti shumëfunktional në Feraj, në vlerën 152 milionë lekë. Në investimet për modernizim projekti kryesor është projekti i modernizimit me mjete transporti dhe speciale për Forcat e Armatosura, investim ky i domosdoshëm për siguruar operacionalitetin dhe gatishmërinë sipas normave, por edhe për të pajisur kapacitetet e dislokueshme që do të marrin pjesë në stërvitjet dhe në operacionet e aleancës.

Investime do të ketë edhe për ngritjen e sistemit të informacionit, për gjeografinë dhe infrastrukturën në Institutin tonë IGJEU, 50 milionë lekë, zhvillimin e kapaciteteve të Agjencisë së Inteligjencës (AISM) 114 milionë lekë, përmirësimin e ruajtjes të sigurisë, të kushteve të jetesës, të punës dhe të stërvitjes në batalionin e mbështetjes në Shtabin e Përgjithshëm, 101 milionë lekë.

Për programin e arsimit ushtarak, siç jua thashë, arsimi mbetet prioritet për periudhën në vazhdim. Do të ketë investime në infrastrukturë për ndërtimin e godinës shumëfunktionale të Akademisë së Forcave të Armatosura në shumën 363 milionë lekë, si dhe kompletimi me pajisje dhe orendi për krijimin e kushteve bashkëkohore për mësim, jetesë dhe pushim 47 milionë lekë.

Ky investim në përmirësimin e arsimit dhe kualifikimit don të ndikojë në motivimin dhe profesionalizmin e personelit të Forcave të Armatosura, që tashmë trajnohet apo edukohet në një institucion të formësuar sipas modelit të Akademisë Ushtarake West Point.

Në përfundim, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2024 është buxheti i parë që përmbush financimin prej 2 % të GDP-së, duke mundësuar intensifikimin e procesit të modernizimit të Forcave të Armatosura, duke zhvilluar kapacitetet e nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues, detyrave ligjore dhe detyrimeve që kemi në kuadrin e aleancave tona strategjike. Pa dyshim që këto aleanca do të vijojnë të mbeten garancia jonë më e lartë për të gëzuar siguri, stabilitet dhe prosperitet për qytetarët shqiptarë, por pa dyshim që ky nuk mund të jetë një udhëtim i lirë. Skenarët brutalë të luftës në Ukrainë, në Lindjen e Mesme apo shkëndijat e konfliktit në rajon nuk janë kujtime të së shkuarës, por një realitet, sepse vlerat dhe interesat kombëtare mund të cenohen në çdo moment. Në këtë kontekst modernizimi i vazhdueshëm i sektorit të mbrojtjes dhe i Forcave të Armatosura, si një nga instrumentet e fuqisë kombëtare është thelbësor për adresimin e kërcënimeve të brendshme dhe përmbushjen e angazhimeve në kuadër të mbrojtjes kolektive. Të mbledhura bashkë, ato lartësojnë nocionin e qëndrueshmërisë së vendit, nën frymën e nenit 3 të Aleancës së NATO-s, me një qasje ndërshtetërore dhe qeverisëse.

Jam shpresëplotë se me mbështetjen tuaj ky buxhet do të miratohet, dhe të gjitha prioritetet tona, të gjitha objektivat që u mundova të përmendja brenda kohës së lejuar, me sa më shumë detaje që munda, do të realizohen.

Edhe diçka të fundit, para se të vazhdojmë me pyetjet, përgjigjet dhe komentet tuaja. Ju e dini se nën përgjegjësi të Ministrisë së Mbrojtjes, nën përgjegjësinë tonë janë edhe rezervat e shtetit. Ne duam të bëjmë edhe aty një kapërcim të rëndësishëm, sepse janë të lidhura me sigurinë, mbrojtjen, apo mbrojtjen civile, janë të lidhura me nevojën për të pasur gjithnjë në dispozicion e më tepër rezerva materiale e ushqimore. Ne duhet të kërkojmë mirëkuptim nga ana e Ministrisë së Financave për të bërë disa reflektime, që kanë qenë të ditëve të fundit në buxhet. Sigurisht, brenda buxhetit që kemi në dispozicion duam të bëjmë një modifikim, me mirëkuptimin tuaj, për të plotësuar dhe kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, për t'u dhënë atyre një fond prej 900 milionë lekësh, pra afro 1 miliard lekë, për të plotësuar të gjitha nevojat e mundshme me rezerva materiale e ushqimore, sipas kuadrit ligjor në fuqi, pra VKM-së përkatëse. Pra, dua të them se edhe në lidhje me atë kuadër që jemi duke rishikuar, na duhet që diku të ulim por diku edhe të shtojmë, sikundër e thashë, edhe në reflektim të kërcënimeve që vijnë

nga fatkeqësitë natyrore. Për fat të keq po edhe për fat të mirë, brenda pak vitesh krijuam një eksperiencë në menaxhimin e fatkeqësive natyrore shumë kritike, duke filluar nga tërmeti i 2019-ës, më pas me pandeminë, duke vijuar me zjarre, përmbytje. Ne jemi një nga rajonet më të ekspozuara në Europë sa i përket të gjitha llojeve të emergjencave e të fatkeqësive natyrore, ndaj kësaj duam t'i qasemi me një kuadër tjetër ligjor, me kërkesa të reja, me përmirësim të infrastrukturës logjistike, por edhe të mallrave, të materialeve ushqimore, joushqimore e industriale në dispozicionin tonë.

Jam i hapur, që së bashku me bashkëpunëtorët, t'u përgjigjem pyetjeve tuaja.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Brenda gjashtëdhjetë minutash na bëtë një panoramë të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2024. Unë do të doja t'ia jepja fjalën zotit Qefalia, si relator, anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Do të doja një këndvështrim tjetër, jo nga ai i Ministrisë së Mbrojtjes, në lidhje me buxhetin, pa na lexuar dhe relacionin.

Fjala është për ju, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Dëgjohem, besoj.

Nasip Naço – Po.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti Ministër, për gjithë ekspozenë që bëtë para komisionit!

Natyrisht, ishte vërtet kohë e gjatë që ju referuat, por bëtë shumë mirë, pasi jemi në një kohë kur situata gjeopolitike në rajon e më gjerë ka marrë përmasa të mëdha, ndaj ishit në të drejtën tuaj për të shpalosur buxhetin për vitin 2024.

Ashtu siç e tha edhe kryetari, unë do të flas në mënyrë më të shkurtuar, për të bërë prezent para anëtarëve të nderuar të Komisionit të Sigurisë, pjesë e të cilit do të doja të ishte edhe opozita, pasi këtu kemi të bëjmë me çështjet kombëtare, por kjo është zgjedhja e tyre. Do të doja të evidentoja faktin se kemi një projektbuxhet, i cili është shumë më i ndryshëm se vitet e tjera. Kemi një rritje prej gati 20 %, nga 39 milionë e 957 ka vajtur në 48, 388 milionë, një buxhet që na ka mundësuar një kapërcim epokal, do të thosha, për sa u përket standardeve dhe kërkesave të vendosura nga partnerët tanë dhe nga NATO. Tashmë Shqipëria e ka përmbushur angazhimin që kishte marrë në Samitin e Uellsit, për të përmbushur vlerën 2 %. Tani Shqipëria renditet në

pesëmbëdhjetëshen e parë të vendeve që e kanë përmbushur këtë kriter. Kjo është një arritje pozitive që na bën krenarë të gjithë shqiptarëve, por bën krenare edhe Forcat e Armatosura, që tashmë janë më dinjitoze dhe me autoritetin e duhur.

Të nderuar kolegë, siç e thashë në fillim, unë nuk dua të ndalem gjatë, por ajo që do të doja të sillja në vëmendjen tuaj, është fokusi ku është mbështetur ky buxhet për vitin 2024. Më vjen mirë që kriteri kryesor është ruajtur, me qëllim lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut. Më vjen mirë që ministri e përmendi faktin se ushtarakët vërtet janë me uniformë, por ata janë edhe qytetarë, dhe se ndihma që u jepet atyre qoftë në trajtimin, qoftë në veshjen, por qoftë edhe në ndihma të tjera që lidhen me shërbime të ndryshme shëndetësore, janë tregues i vëmendjes së vazhdueshme të qeverisë shqiptare.

Sëftyti, fokusi kryesor i këtij buxheti ka të bëjë edhe me implementimin në mënyrë cilësore të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga të qenit të Shqipërisë anëtare e NATO-s, si dhe të nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që kemi nënshkruar ne si Kuvend me vendet që ndihmojnë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë dhe të modernizimit. Modernizimi, që është pika dhe elementi kryesor, që ministri e ceku me të drejtë, dhe unë nuk do të ndalem ta përmend, që ka të bëjë qoftë me pajisjen e batalionit të këmbësorisë, por qoftë edhe të forcave speciale, apo me pajisjen me teknologji të mjeteve të tjera të luftimit, detare dhe ajrore, të gjitha këto tregojnë edhe një herë vëmendjen e qeverisë shqiptare e posaçërisht të Ministrisë së Mbrojtjes ndaj Forcave të Armatosura shqiptare.

Zoti kryetar, duke folur edhe në emër të kolegëve të mi, më lejoni ta përshëndes Ministrinë e Mbrojtjes dhe gjithë ekipin drejtues për angazhimin që ka bërë në lidhje me realizimin e buxhetit të vitit 2023. Ne si Komisioni i Sigurisë kemi asistuar dhe kemi ndjekur nga afër zbatimin e buxhetit për vitin 2023. Ndoshta këtu vlerësimet maksimale shkojnë për ministrin, zotin Niko Peleshi dhe për shefin e Shtabit të Përgjithshëm, i cili na ka bërë krenarë. Unë flas edhe në emër të kolegëve, pasi qenia pjesë e Komisionit të Sigurisë të disa kolegëve tanë, të cilët vijnë nga Forcat e Armatosura, përcjell mesazhin e atyre ushtarakëve, që ministri Peleshi u ka qëndruar afër duke këmbëngulur në qeveri qoftë për rritjen e rrogave të tyre, qoftë për veshjen e qoftë për pajisjen me armatimin përkatës.

Kjo ka bërë që unë si anëtar i Delegacionit Shqiptar të Asamblesë së NATO-s, bashkë me kolegun Kollçaku dhe zonjën Kodheli, të jemi ndjerë krenarë kur kemi dëgjuar fjalë dhe vlerësime

pozitive për forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë, që në mënyrë dinjitoze u janë besuar misione dhe detyra, të cilat i kanë përmbushur me sukses.

Duke mos dashur të marr më shumë kohë, ftoj kolegët e mi që ta votojmë këtë projektbuxhet. Roli dhe misioni i Forcave të Armatosura, tashmë edhe me plotësimin e kriterit 2 % të buxhetit, do të jetë në lartësinë e duhur, duke na bërë të ndjehemi krenarë edhe neve si anëtarë të komisionit.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Qefalia për fjalët që thatë në lidhje me buxhetin, për stafin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe zotin Peleshi!

Edhe unë solidarizohem me ju. Do të doja që kolegët, me pyetjet që do të bëjnë, ta shohin nga një këndvështrim i ri, për ta plotësuar apo ndihmuar më shumë buxhetin.

Fjalën e ka kërkuar zoti Kollçaku!

Zonjës Dhima dhe kolegëve të tjerë, sipas radhës, do t'u lutesha edhe një herë që t'u drejtonit pyetje zotit ministër, sepse pas pyetjeve do të kemi fazën e diskutimeve.

Faleminderit!

Zoti Kollçaku, fjala për ju!

Bardhyl Kollçaku – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj ministrin dhe stafin e tij për prezantimin e hollësishëm të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2024. Natyrisht, është lajm i mirë jo vetëm për personelin e Mbrojtjes, po për të gjithë shqiptarët, që një nga angazhimet më madhore, që është realizimi 2 % i buxhetit bëhet fakt këtë vit. Kësisoj, ne i bashkohemi atij klubit të vogël të vendeve të NATO-s, që e kanë përmbushur këtë angazhim, por me vëmendjen se në vijim 2-përqindëshi të jetë dyshemeja, pasi do të kërkojmë që buxhet ta kalojë 2-përqindëshin vitet e ardhshme, pasi që dhe sfidat e kërcënimit janë në rritje, gjë që e ceku edhe ministri i Mbrojtjes.

Unë kam dy-tre pyetje për ministrin. Ndoshta ai e preku pak, por ne mezi presim që baza e NATOS-s në Kuçovë të inaugurohet në muajin janar. Ashtu siç e kam thënë edhe në takimet që kemi pasur në komision apo në takimet me ministrin, e rëndësishme është të dimë që pas përfundimit të kësaj baze, të operacionalitetit të saj, çfarë planesh ka Ministria e Mbrojtjes, së bashku me aleancën, për popullimin e kësaj baze me forca, me trupa, me armatime, pajisje, teknikë, në mënyrë që ajo të mos mbetet një ngrehinë boshe, jo vetëm të projektojë siguri për rajonin tonë, por edhe për zonën ku unë përfaqësoj ky investim madhor të mundësojë vërtetë një gjallëri dhe një

kuptim. Kësisoj, unë dua të dëgjoj nga ministri, nëse ka ndonjë plan konkret në bashkëpunim me aleancën apo partnerët strategjikë, në lidhje me përdorimin e bazës, pas inaugurimit të saj në 2024-ën e më tej.

Pyetja e dytë që kam për ministrin ka të bëjë me industrinë ushtarake. Kjo është fjalë e madhe, por sot është fjala kyç në selinë e NATO-s, në të gjitha vendet, jo vetëm ato që janë jo vetëm në kufi me Rusinë, për shkak të agresionit rus ndaj Ukrainës. Nevoja e sotme për armatim dhe municion është shumë e lartë. Dua ta pyes zotin ministër nëse ka plane, projekte konkrete për ish-uzinën mekanike të Poliçanit, atë të Mjeksit apo të Gramshit, për biznesmenë, le të themi, ose struktura të sigurisë së partnerëve tanë, për kthimin e tyre në uzina ku prodhohen armatim e municion jo vetëm për Forcat e Armatosura, por ndoshta edhe për më tepër.

Pyetja e tretë është në lidhje me hartën e kontributeve. Ministri theksoi se do të shtohet kontributi ynë në kompani në kuadrin e shkurajimit; në Rumani do të shtohet një togë në kuadrin e BE-së. Në vitet që vijnë angazhimi ynë kryesor është të integrohemi në Bashkimin Europian. Në kuadrin e operacioneve të BE-së, a ka ndonjë plan konkret për shtimin e prezencës dhe ndryshimin e hartës së përfaqësimit në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme? Këtë pyetje ia bëra dje edhe zotit Hasani, në mënyrë që përfaqësimi ynë ushtarak, jo vetëm në misione, por edhe në shtabe e komanda, të reflektojë edhe prioritetet kombëtare.

Pyetja e fundit, por jo e fundit për nga rëndësia, zoti Ministër, është kjo: ne jemi në dijeni që ju keni dërguar në qeveri projektligjin për rezervistët. Në buxhetin e vitit 2024 a do të ketë ndonjë fond të dedikuar, të parashikuar për rezervistët, apo do të jetë vetëm viti i plotësimit të akteve ligjore e nënligjore?

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Kollçaku!

Fjala është për ju, zoti Ministër!

Niko Peleshi – Shumë faleminderit për pyetjet, zoti Kollçaku!

Po përgjigjem shkurt: në lidhje me planet për Kuçovën, për popullimin, siç e quajtet ju, së pari, në Kuçovë kemi filluar punën për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për qendrën e sistemeve ajrore pa pilot. Pra thënë thjesht, për qendrën e dronëve, dronëve “Bajraktar”, të cilët në fillimin e vitit që vjen, në fund të tremujorit të parë, në fillim të tremujorit të dytë do të jenë në gatishmëri, do të jenë aty së bashku me personelin e trajnuar. Pra, në Kuçovë do të vendosim këtë sistem të ri, këtë kapacitet të ri që shtohet.

Gjatë prezantimit tim fola për flotën e helikopterëve “*black hawk*”. Dy helikopterët e parë që vijnë fillim të janarit do të vendosen në bazën tonë ajrore të Farkës. Aty po ndërtojmë edhe hangarët për helikopterët “*black hawk*”. Siç e thashë, kjo flotë do të rritet deri sa të shkojë në periudhën afatmesme e afatgjatë 2029-2030, kur parashikojmë të kemi gjashtë helikopterë, plus katër helikopterë të tjerë. Ky vit do të jetë një vit gjatë të cilit do të fillojnë investimet për ta shtuar flotën. Pra, le të themi, deri në vitin 2026-2027 parashikojmë të kemi shtuar dy apo tre të tjerë. Kemi menduar të vendosen në Kuçovë edhe këto kapacitete të reja, pra kjo pjesë e flotës së helikopterëve “*black hawk*”, që do të vijnë gjatë viteve në vazhdim. Prandaj po rikonstruktojmë një hangar të vjetër, por jemi në procedurën për të ndërtuar edhe një hangar të ri, në mënyrë që të kemi aty infrastrukturën dhe kapacitetet e mjaftueshme.

Ju e dini se që nga viti 2021 ka filluar seria e stërvitjeve “Defender”. “Defender 2021” dhe “Defender 2023” janë organizuar deri tani me Shqipërinë vend pritës. Në vitin 2021 ne kemi qenë vend kryesor pritës. Rreth pesë-gjashtë mijë trupa, përgjithësisht amerikane, por edhe trupa nga vende tjera të aleancës së NATO-s kanë hyrë nëpër Shqipëri, kanë ndaluar këtu, janë stërvitur këtu e pastaj janë përhapur edhe në vende të tjera të rajonit, ku shtrihet “Defender”. Në vitin 2025 do të kemi “Defender 2025”. Pra “Defender” zhvillohet çdo dy vjet në rajonin tonë, pra një vit në rajonin tonë, një vit në vendet balltike, në Veri të Europës. Kjo bazë do të përdoret gjatë stërvitjes “Defender 2025”, “Defender 2027” e në vazhdim, si dhe gjatë stërvitjeve tjera të shumta, që ne zhvillojmë në bashkëpunim me vendet e tjera të aleancës së NATO-s.

Duhet thënë se kjo është një bazë e hapur për t’u përdorur nga të gjithë aleatët tanë; 31 apo 32 aleatë të NATO-s do ta përdorin bazën taktike ajrore të Kuçovës për stërvitje të përbashkëta dhe për operacione të ndryshme. Padyshim që do të jetë aktive, do të ketë vazhdimisht përdorim dhe personel, që do të jetë aty. Një lajm i mirë për ju, por që e dini, sepse nuk është lajm i ri, është se kemi filluar punën për ndërtimin e hotelit, ndërtimin e kapaciteteve hoteliere në Kuçovë. Siç e kishim premtuar, ish-Shtëpia Ushtarake e Kuçovës do të modernizohet dhe do të kthehet në hotel shumë të bukur dhe shumë modern, të standardit bashkëkohor që do të jetë në përdorim, qoftë të personelit tonë, që shkon me shërbim për të punuar në bazën ajrore të NATO-s Kuçovës, por edhe nga vende të tjera të NATO-s, në kuadër të stërvitjeve dhe përdorimeve të ndryshme që do të kenë. Shumë shpejt do të jetë një *landmark* për qytetin e Kuçovës, sepse ndodhet në qendër, si pothuajse të gjitha ish-shtëpitë e ushtarakëve, që tani do të kthehen në hotele. Edhe një bateri e mbrojtjes

kundërajrore me një togë me rreze të shkurtër, ju e kuptoni shumë mirë, do të vendoset në Kuçovë. Kjo ishte për sa i përket pyetjes së parë. Besoj t'i jemi përgjigjur.

Pyetja e dytë lidhet me industrinë ushtarake. Duhet thënë që jemi mbrapa, e kam fjalën si vend, jo thjesht si Ministri e Mbrojtjes, në ringritjen e industrisë ushtarake, sepse koha e sotme e ka rritur shumë kërkesën. Për fat të keq, për shkak të vatrave të luftërave, të konflikteve është rritur kërkesa për armatime, municione dhe, duke e parë tani si ekonomi, do të ishte dështim nëse ne nuk do të arrijmë ta vendosim sot në punë industrinë e “fjetur” dhe të amortizuar, ish-industrinë ushtarake që kemi pasur në Mjekës, në Poliçan, në Gramsh apo qoftë edhe në vende të tjera që do të gjykohen nga investitorët. Kjo thuhet në parim. Konkretisht, ne po e ndryshojmë qasjen, sepse vazhdimisht të gjitha ministrat e kësaj qeverie apo të qeverive të kaluara kanë qenë të hapur për investime. Investitorë potencialë kanë ardhur në vite, çdo vit, i kanë parë, por nuk ka ndodhur gjë. Nga ana jonë, me thënë të vërtetën, ka munguar një lloj qartësie në raport me çfarë vlere kanë sot këto asete, sa para do të duheshin për t'i vënë në punë? Sa të leverdishme janë? Pra, një lloj studimi fizibiliteti. Ndaj menduam të jemi proaktivë. Kemi kontaktuar me Agjencinë e Prokurimeve të NATO-s, në SPA, që ka kapacitete të përshtatshme për të hartuar studime parafizibiliteti, fizibiliteti, kërkime tregu dhe sot ata na kanë dërguar një raport të parë, le ta quajmë një studim parafizibiliteti për asetet tonat. Ne tani kemi më shumë qartësi, sepse kemi edhe shifra sa investime do të duheshin; cila është kërkesa në tregun global; cilat janë mallrat më të kërkuara. Pra, kemi bërë disa hapa para. Ka edhe investitorë nga shtetet e NATO-s që kanë treguar interes, por le të themi që janë shfaqje fillestare, akoma të pakonkretizuara, por po punojmë duke qenë shumë të hapur me ta, pa dyshim, por edhe duke qenë proaktivë, siç e shpjegova duke qartësuar së pari veten tonë.

Për sa u përket operacioneve dhe misioneve të BE-së, me shumë të drejtë zoti Kollçaku tha që, duke qenë se BE-ja është edhe ambicia jonë politike, destinacioni ynë politik, na duhet të jemi më aktivë edhe në misionet e BE-së. Ne kemi sot prezencën e një personeli në misionin “ALTHEA” në Bosnje-Hercegovinë, por do të jemi atje me një togë, pra jemi angazhuar që vitin që vjen, në vitin 2024, të atashojmë një togë në Bosnje-Hercegovinë në kuadrin e “ALTHEA”-s. Kemi ligjin “Për rezervistët” në qarkullim. Nuk është thjesht një vizion, një ambicie, por e kemi buxhetuar për këtë vit. Synojmë, dhe do të arrijmë patjetër që pas miratimit të ligjit të ngremë kompaninë e parë të rezervistëve me një personel prej rreth 150 rezervistësh në Elbasan, e cila do të ketë profilin e përballimit të emergjencave civile, pastaj muaj pas muaji, vit pas viti do ta rrisim,

do ta plotësojmë forcën tonë rezerviste drejt numrit 2000 apo 2200 për të qenë më i saktë, që parashikohet edhe në ligj. Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Mahmutaj, pyetje.

Kasëm Mahmutaj – Ju falënderoj!

Që në fillim të mbledhjes më bëri përshtypje që mungon opozita, por të paktën pozita duhej ta vlerësonte këtë mbledhje, sepse duket që edhe kuorumi nuk u formua. Kam një pyetje të drejtpërdrejtë për zotin ministër: a është parashikuar në këtë buxhet pagesa e punonjësve të ish-Kombinatit Mekanik në Poliçan? Nëse po, si do të bëhet shpërndarja e saj?

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Mahmutaj, për vërejtjen, sugjerimin, si dhe lavdërimin që bëtë! Fjala është për ju, zoti Ministër.

Niko Peleshi – Unë jam përgatitur edhe për një interpelancë me kryetarin e komisionit, zotin Naço, lidhur me pagimin e detyrimeve të pagave të prapambetura, të sigurimeve shoqërore, të vendimeve gjyqësore, të kamatëvonesave e të tjera, të gjeneruara në vite në ish-Kombinatit Mekanik të Poliçanit. E kishim në agjendën e javës së kaluar, por, për shkak të ngjarjeve në Kuvendin e Shqipërisë, nuk mundëm ta zhvillonim, gjithsesi po e shfrytëzoj këtë dritare për të dhënë 2-3 informacione. Ish-Kombinati i Poliçanit ka statusin e ndërmarrjes shtetërore, një status i veçantë i një shoqërie tregtare, të themi, me aksione 100% shtetërore; nuk ka aksione, por kapitali është shtetëror, i gjithi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe kjo është varësia, lidhja që ne kemi pasur me aktivitetin e këtij ish-Kombinati. Sot ai është “i fjetur”, nuk është në aktivitet, punonjësit janë reduktuar në një numër, sa gishtat e një dore.

Kasëm Mahmutaj – Nuk punon fare, zero, nuk janë reduktuar, është “i vdekur” ish-Kombinati sot.

Nasip Naço – Zoti Mahmutaj, ta lëmë të gabojë ministri, pastaj të dy e bëjmë “copa-copa”.

Niko Peleshi – Unë thashë “i fjetur”, jo “i vdekur”, sepse i fjeturi edhe zgjohet. I fjeturi nuk punon, por mund të zgjohet. Aty nuk ka aktivitet, por është minimumi i nevojshëm për të mbajtur, si me thënë, asetin dhe për të menaxhuar pa dyshim edhe rezervat materiale. Është një numër prej dhjetëra punëtorësh, të cilëve kontratat e punës u janë zgjidhur dhe për një periudhë të gjatë pagat nuk u janë paguar, sigurisht, edhe sigurimet shoqërore. Disa prej tyre kanë edhe vendime gjyqësore të fituara, por dua të sqaroj se, sipas ligjit, ndërmarrjet shtetërore apo sh.a-të shtetërore, të dyja forma juridike të organizimit të shoqërisë, trajtohen njëjloj; detyrimet e tyre nuk

paguhen nga institucionet shtetërore, është thënë e zeza mbi të bardhë në ligj. Ka vetëm një presje, si të thuash, me përjashtim të rasteve kur vendoset me ligj të veçantë. Tani ne e kemi gjykuar që ka disa sh.a shtetërore, shoqëri aksionere shtetërore apo ndërmarrje shtetërore që në vite mund të kenë gjeneruar detyrime, dhe nuk është e thënë që të bëjmë ligj të posaçëm për secilën prej tyre, përndryshe nuk kishte pse të ishte ndalimi i të drejtës për të paguar detyrimet nga institucionet shtetërore të ndërmarrjeve shtetërore, por ne e kemi vlerësuar si të veçantë rastin e ish-Kombinatit të Poliçanit, sepse është një fushë sot tepër kritike. Pra, bëhet fjalë për një industri në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, për të cilën, siç e thamë pak më lart, kemi interes ta rivendosim në punë. Para se të fillonte agresioni rus në Ukrainë, kur dukej se lufta konvencionale nuk kishte ndonjë opion, Shqipëria vazhdonte të demilitarizohej, pra kryefjala, kur binte fjala për industrinë ushtarake nuk ishte militarizimi, por demilitarizimi. Sot kushtet kanë ndryshuar dhe ne po flasim për riaktivizim të njësisë ushtarake. Në këto kushte, na duket e shëndetshme të krijojmë një mjedis sa më pak acid, në kuptimin e pakënaqësisë legjitime dhe të kuptueshme të atyre punëtorëve që kanë punuar në Poliçan dhe që nuk janë paguar, jo për fajin e Ministrisë së Mbrojtjes, jo për fajin e qeverisë shqiptare, por për shkak se ajo ndërmarrje nuk mundi dot të mbijetonte. Ligji është shumë i qartë: një ndërmarrje i paguan vetëm detyrimet e saj dhe nuk mund t'ia faturojë shtetit, përndryshe do të krijoheshin gropa buxhetore të frikshme në buxhetet tona. Megjithatë, për ta thënë shkurt, duke vlerësuar specifikën, veçantinë që kjo industri dhe ky kombinat ka, interesin që kemi sot për ta rivendosur atë në punë, sa më shpejt të jetë e mundur, hapjen e dyerve për investitorë të huaj apo vendas për të investuar aty, ne kemi ndërmarrë iniciativën për një ligj të posaçëm për pagimin e detyrimeve, jo të të gjitha detyrimet, sigurisht, por pagat dhe sigurimet shoqërore për punëtorët e ish-Kombinatit të Poliçanit.

Vlera, fatura e këtij projektligji është afro 85 milionë lekë të rinj, rreth mbi 800 mijë euro. Ky projektligj nuk mund të paragjykohet dot nga ana jonë nëse do të gjejë dritën e miratimit në Këshillin e Ministrave, më pas në Parlament. Ne kemi të drejtë vetëm të propozojmë. Ne po e ndjekim, ligji është në qarkullim, kemi korrespondencë me Ministrinë e Financave, kemi bërë disa plotësime, disa saktësime, kemi dhënë përgjigje edhe për vërejtjen që na është bërë me shumë të drejtë për krijimin e një precedenti, por e shpjegova edhe më lart, nuk mundet dot që qeveria shqiptare t'i paguajë të gjitha detyrimet që krijon çdo sh.a me pjesëmarrje shtetërore. Shpjegimin që e parashtrova sot para jush, ia kemi bërë edhe Ministrisë së Financave. Besoj që kjo hallkë do të kalojë, por më pas do të miratohet në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvendin e Shqipërisë.

Kështu, po e adresojmë këtë çështje. E di që ka shumë, shumë interes nga ish-punëtorët e ish-Kombinatit, të cilët më shkruajnë përditë. Ju kërkoj mirëkuptim, pasi po bëjmë maksimumin e mundshëm, pra po sforcohem të bëjmë maksimumin e mundshëm, duke ua shpjeguar edhe ndërmarrjeve të tjera që nuk janë në sektorin tonë, por tani po flas si përfaqësues i qeverisë, të mos zgjojnë orekse për të pretenduar pagimin e detyrimeve nga shteti, nga qeveria e Shqipërisë, sepse ligji e ndalon këtë gjë. Një ligj i posaçëm, për arsye të posaçme, siç është Poliçani, e lejon, e mundëson, por kjo nuk mund të kthehet në një normë. Këtë shpjegim po e bëj edhe publikisht për ndërmarrjet e tjera, jo vetëm për ato të fushës së sigurisë dhe të mbrojtjes, por edhe për çdo fushë tjetër.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Deliu, pyetje, më pas zonja Dhima.

Denis Deliu – Faleminderit, kryetar!

I nderuar Ministër,

Kam disa pyetje shkurt.

Pyetja e parë: a ka në plan Ministria e Mbrojtjes të shtojë trupa në Kosovë? A janë prioritet AISM-ja dhe Forcat Speciale?

Pyetja e dytë: a po punon Ministria e Mbrojtjes për miratimin e vështirësive për reparte të veçanta, me natyrë të veçantë pune dhe rrezikshmëri, pra vështirësi për Forcat Speciale, për pilotët, komandot, zhytësit, EOD-në, AISM-në dhe Policinë Ushtarake? Po në këtë pikë ne kemi diskutuar shumë herë edhe në projektbuxhetet e tjera edhe si deputetë, por edhe me ministrin në Komisionin e Sigurisë, por edhe në raporte miqësore, e takime miqësore, unë jam shumë i interesuar, jo vetëm se kam qenë pjesë e Forcave Speciale, por e shoh shumë të rëndësishëm miratimin e një ligji për Forcat Speciale të ushtrisë. A është në vëmendjen e Ministrisë së Mbrojtjes miratimi i këtij ligji për vitin 2024?

Pyetja e tretë: çfarë do të bëjë Ministria e Mbrojtjes që Spitali i Traumës të njohë realisht statusin e ushtarakut? Shoh që në projektbuxhetin e vitit 2024 garantohet trajtimi i rreth 100 mijë urgjencave të shtuara te Spitali i Traumës dhe i rasteve ambulatorë, kosto këto që do të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Për vitin 2023 kishim planifikuar edhe një klinikë dentare për ushtarakët. A do të kenë shërbim dentar falas?

Pyetja e katërt: çfarë mund të bëjë Ministria e Mbrojtjes që mjekët ushtarakë të trajtohen njësoj me mjekët në Ministrinë e Shëndetësisë?

Pyetja e pestë: misioni në Bullgari, me sa informacion kam, paguhet rreth 60 mijë lekë, unë sugjeroj që Ministria e Mbrojtjes ta shikojë këtë, pasi kjo pagesë është shumë e vogël, është sa një dietë e një punonjësi të administratës shtetërore që lëviz jashtë rrethit këtu në Shqipëri.

Para disa ditësh pashë që kemi miratuar me VKM siguracionin e jetës për punonjësit e Policisë Ushtarake, ju përgëzoj për këtë. Unë ju sugjeroj që, edhe punonjësit e Forcave Speciale, edhe pilotët të kihen në vëmendje, sepse kryejnë detyra me rrezikshmëri shumë të lartë.

Unë ju falënderoj, zoti Ministër dhe ndihem shumë i lumtur që buxheti i Ministrisë e Mbrojtjes ka arritur në nivelin 2%. Faleminderit, zoti kryetar!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Deliu!

Fjala është për ju, zoti Ministër.

Niko Peleshi – Zoti Deliu, faleminderit!

Në Kosovë, në KFOR, po, planifikojmë të shtojmë dy toga vitin që vjen, pra rreth 60 vetë personel ushtarak.

Sa i përket vështirësisë së Forcave Speciale, ato marrin gjithmonë vështirësinë më të lartë në hartën e vështirësive të paguara, pra kushteve të punës, në Forcat e Armatosura. Natyrisht, ka gjithmonë vend për më mirë dhe për më shumë. Unë nuk mund ta them pa u miratuar, por e ne kemi në proces rishikimi e VKM-së nr. 224 “Për vështirësitë në kushtet e punës”, ku, zoti Deliu, ju siguroj se të parët në janë Forcat Speciale. Kemi propozuar një rritje të qenësishme, me më shumë se 2-3 herë (me herë).

Kuptohet, ne e kemi në dorë të propozojmë, por nuk mund të garantojmë miratimin, dhe nuk është çështje e mungesës së vullnetit, sepse tashmë të gjithë shqiptarët e dinë që qeveria shqiptare ka vullnet të rrisë pagat, të rrisë pagën mesatare, të rrisë pagesën për vështirësitë (në rastin që po flasim), por është shumë e nevojshme që të këtë një harmonizim, sepse kemi Forcat e Armatosura, por kemi edhe forca të tjera në fushën e sigurisë, si: Policia e Shtetit apo Policia e Burgjeve. Po harmonizojmë shpërblimet ndërmjet këtyre forcave, që të kemi një normë rritjeje të pagave apo normën e rritjes së pagesës së vështirësive që të bëjë sens dhe të këtë logjikë, pra të mos jetë “Njëri gozhdës e tjetri patkoit” -siç thotë populli. Në këtë kuadër, diku do të ulim e diku do të shtojmë, por ju siguroj se unë po bëj maksimumin dhe së shpejti do të kemi një rishikim të VKM-së nr. 224, bashkë me Forcat Speciale në prioritetin e prioritetëve.

Do të punojmë më shumë që t'i rritim rekrutimet, sepse kemi akoma mundësi që t'i shtojmë efektivët në Forcat Speciale dhe mendojmë se, duke rritur pagën bashkë me pagesën e vështirësisë, do të jemi më atraktivë për të rekrutuar vajzat dhe djemtë më të mirë në Forcat Speciale.

Në lidhje me pyetjen tuaj e tretë, nëse kemi një ligj të posaçëm për Forcat Speciale, nuk e kemi dhe nuk e kemi menduar, nuk na bën akoma sens, sepse i bie që edhe forcat e tjera të kërkojnë ligje të posaçme. Unë e di ndjeshmërinë tuaj për Forcat Speciale, por çfarë mund t'i themi dikujt që lobon për Forcat Tokësore, Forcat Ajrore apo Forcat Detare?! Nuk e kemi gjykuar deri tani të dobishme që të bëjmë një ligj të posaçëm për Forcat Speciale.

Në lidhje me pyetjen për Spitalin e Traumës apo, siç quhet në zhargonin e përditshëm, Spitalin Ushtarak, keni të drejtë, ne aty duhet t'i shtojmë shërbimet e dedikuara për ushtarakët. Ndaj, këtë vit ne kemi filluar dhe jemi në fund të ndërtimit të dy kapaciteteve të dedikuara posaçërisht vetëm për ushtarakët, që janë: laboratorin e analizave mikrobiologjike, natyrisht është i fjalës së fundit dhe do të jetë pa pagesë, si dhe klinika dentare pa pagesë për ushtarakët.

Në lidhje me kërkesën tuaj, zoti Deliu që mjekët ushtarakë të trajtohen si mjekët civilë, edhe kjo do të marrë zgjidhje në kuadër të rishikimit të VKM-së nr. 2024. Në këtë VKM shtesën e pagës për mjekët ushtarakë e kemi futur një lloj siç është për mjekët civilë, sepse sot, për ta sqaruar edhe për publikun, mjekët ushtarakë paguhën sipas gradës, jo si mjekët civilë apo mjekë të tjerë, të cilët, siç e dimë, për çdo specialitet kanë marrë një rritje të konsiderueshme në pagë. Mjekët ushtarakë kanë marrë rritje page, por sipas gradës dhe jo më shumë së aq, ndërkohë që ne tani do t'u japim pagesë më të lartë, pra jo vetëm sipas gradës, por edhe sipas rritjes që ka bërë qeveria për mjekët civilë.

Sa i përket pyetjes për trajtimin e togës sonë në Bullgari, trajtimi është në bazë të vlerësimit të nivelit të rrezikut, pra nuk është se kemi vendosur një trajtim diete ditore apriori, pasi kemi një hartë të nivelit të rrezikut dhe, sipas hartës kemi atë lloj trajtimin. Por, që të mos keqkuptohemi me publikun, sepse ju i dini mirë detajet, madje më mirë se unë për këtë pjesë të Forcave të Armatosura, për të cilën me shumë të drejtë keni shumë ndjeshmëri, për shkak se keni kontribuar aty, pagesat, dietat dhe pagesat në misione janë dinjitoze dhe të krahasueshme me të gjitha vendet e tjera të NATO-s. Ushtarakët tanë në misione paguhën me standardin e vendeve anëtare të NATO-s, si në dieta, ashtu dhe në pagesa. Nëse ka vend për përmirësim apo për rishikim të hartës së nivelit të rrezikut, natyrisht që ne e mbajmë shënim vërejtjen tuaj, por edhe pagesa, e thënë me gjuhën popullore, prej 60 mijë lekësh në ditë, vetëm për dietë ushqimore nuk është pak. Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Deliu!

Faleminderit, zoti Ministër!

Zonja Dhima ka kërkuar fjalën për të bërë pyetje dhe komente.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj ministrin e Mbrojtjes, zotin Peleshi, për prezantimin e projektbuxhetit për vitin 2024, njëkohësisht edhe për buxhetin afatmesëm 2024-2025! Njëkohësisht, falënderoj për angazhimin dhe për mbështetjen jo vetëm ministrin Peleshi, por edhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe strukturat e Shtabit të Përgjithshëm, kryesisht repartin e Poshnjes, të cilët në këtë verë të zgjatur kanë dhënë kontributin e tyre dhe mbështetjen në menaxhimin e situatës së zjarreve dhe të emergjencave civile.

Buxheti për vitin 2024 është një buxhet që përmbush një nga objektivat që ka Shqipëria si anëtare e NATO-s, duke akorduar një buxhet 2% të PBB-së, i cili nuk është thjesht për vitin 2024, por vazhdon edhe për vitet 2025 dhe 2026. Po kështu, me politikat dhe me objektivat e synimet që ka Ministria e Mbrojtjes, ajo do të mbështesë kryesisht personelin, promovimin e karrierës, do të mbështesë trajtimin e ushtarakëve, rritjen e transparencën dhe të llogaridhënies, modernizimin e Forcave të Armatosura për të plotësuar objektiva, si dhe kapacitetet e NATO-s bashkë me ato kombëtare për infrastrukturën, që janë kryesore për Forcat e Armatosura.

Personalisht më vjen mirë që prej disa vitesh Ministria e Mbrojtjes mbështet Forcat e Armatosura, duke lartësuar figurën e ushtarakëve në drejtim të rritjes së pagave, pasi këtë viti që po mbyllim, por edhe vitin e kaluar pagat e ushtarakëve janë rritur me 30%, po kështu edhe për vitin 2024 parashikohet rritje e pagave nga 7 deri në 22%, si dhe mbështetjen e ushtarakëve të Forcat e Armatosura me strehim dhe me trajtim ushqimor.

Nasip Naço – Zonja Dhima, bëni pyetje, jo diskutime.

Antoneta Dhima – Do të bëj edhe pyetje, edhe diskutim, meqë ju ma dhatë fjalën, zoti kryetar, sepse mund të jem e fundit në listën e diskutantëve që bëj pyetje dhe të diskutime.

Njëkohësisht, vlerësohet modernizimi i Forcave të Armatosura me armatimet dhe municionet e nevojshme, po kështu edhe plotësimi i detyrimeve, që ju, zoti kryetar, e theksuat në fjalën tuaj, prej 2% i anëtarësimit në NATO.

Kam tri pyetje, zoti Ministër.

Ministria e Mbrojtjes në programin e saj për buxhetin e vitit 2024 ka gjithsej 7 programe, ku, në diskutimin tuaj, ju relatuat mbështetjen buxhetore me fonde. Ajo që më bie në sy është fakti

që programi “Mbështetja e luftimit”, në krahasim me vitin 2023, ulet në përqindje nga 19,2% në 16,5%, si dhe mbështetja sociale për ushtarakët ulet nga 13,5% në 10,8%. Cila është arsyeja që këto fonde janë parashikuar me ulje krahasuar me vitin 2023?

U përmend pak edhe nga kolegët parafolës trajtimi i Spitalit të Traumës në buxhetin e vitit 2024, ku garantohet trajtimi i rreth 100 mijë urgjencave dhe të shtruarve në Spitalin e Traumës, si dhe rastet ambulatorie, dhe kostoja e financimit për këtë spital shkon në 1,4 miliardë lekë. Ky fond i planifikuar për Spitalin e Traumës a mund ta realizojë misionin dhe objektivat që ka ky spital për t’u shërbyer qytetarëve, të cilët drejtohen aty për të marrë shërbim urgjent, pasi dihet që ai trajton raste urgjente, që nuk mund të trajtohen në spitalet e tjera, si ato bashkiake dhe në QSUT?

E treta, meqë jemi në mbyllje të buxhetit për vitin 2023, besoj se për një muaj mbyllet, do të doja të dija nga ju dhe nga stafi, i cili ndjek buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, si paraqitet realizimi i shpenzimeve paraprake për vitin 2023?

Do të kërkoja nga burimet e brendshme më shumë informacion për pjesën e investimeve dhe realizimin e investimeve nga emergjencat civile.

Duke shpresuar dhe besuar se buxheti i vitit 2024 do ta realizojë misionin e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe detyrimin që ka Ministria e Mbrojtjes, si anëtare e NATO-s (Shqipëria, në rastin konkret), unë ju uroj suksese në punën dhe angazhimin jo vetëm tuajin, si ministër i Mbrojtjes, por edhe të të gjitha strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

Nasip Naço - Faleminderit, zonja Dhima, për pyetjet, diskutimet dhe komentet!

Zoti Ministër, fjala është për ju.

Niko Peleshi – Ju lutem, edhe një herë pyetjen e dytë, që lidhet me Spitalin e Traumës!

Antoneta Dhima – Në buxhetin e vitit 2024 garantohet, sipas relacionit, trajtimi i rreth 100 mijë urgjencave, që do të trajtohen panë këtij spitali, si dhe pjesa e ambulatorëve, duke akorduar një fond prej 1,4 miliardë lekësh. A mendoni se ky fond i akorduar do ta plotësojë misionin dhe detyrimin që ky spital ka, ose objektivin për të ofruar shërbim cilësor ndaj pacientëve që i drejtohen këtij spitali për të marrë shërbim, pasi dihet që ky spital trajton rastet urgjente, ato raste që nuk mund të trajtohen në spitalet bashkiake, në spitalet rajonale dhe në QSUT?

Faleminderit!

Niko Peleshi - Kryetar, a mundem?

Nasip Naço – Urdhëroni, zoti Ministër!

Niko Peleshi – Faleminderit për pyetjen, zonja Dhima!

Për sa i përket programit “Mbështetja e luftimit”, programi në vlerë nominale nuk është buxhetuar më pak, pra nuk kemi rënie në vlerë nominale, por në përqindje. Duke qenë se buxheti ka rritje me 22%, duket sikur bie në përqindje, por nuk ulet, siç e thashë, në vlerë nominale.

Natyrisht, siç e shpjegova, pjesa më e madhe e buxhetit që shtohet shkon te forcat e luftimit, sepse ai është edhe interesi kryesor më i rëndësishëm i Forcave të Armatosura, pra që të rrisë kapacitetet, të plotësojë objektivat e kapaciteteve të NATO-s dhe të forcojë mbrojtjen kombëtare. Pra, forcat e luftimit janë prioriteti ynë që kap 30% të totalit të buxhetit, pa përfshirë investimet e huaja. Nëse futen investimet e huaja, shkon në 50%.

Duke qenë se u kemi dhënë këtë lloj prioriteti forcave të luftimit, se janë enë komunikuese, siç e kuptoni, duket sikur në përqindje bie. Pra, janë thjesht raporte brenda për brenda buxhetit. Ndërsa në vlerë nominale, të gjitha janë rritur. Edhe buxheti i Spitalit të Traumës është rritur me 300 milionë lekë, krahasuar me vitin e kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mbështetja e luftimit është rritur me 400 milionë lekë, e thënë në euro rreth 4 milionë, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa për Spitalin e Traumës kemi shtuar 300 milionë lekë më shumë, pra rreth 3 milionë euro, sepse ka një projekt ambicioz të këtij spitali (që, siç e dini, ka një varësi dyfishe nga pikëpamja administrative dhe e aktivitetit nga Ministria e Shëndetësisë) për ta modernizuar edhe në infrastrukturë, edhe në pajisje. Ne po e mbështesim sipas kërkesave të tyre. Natyrisht, ky fond i shtuar do të shkojë në përmirësimin e aftësisë së spitalit për t’iu përgjigjur emergjencave të ndryshme dhe ndërhyrjeve, i cili po specializohet gjithnjë e më tepër jo vetëm për personelin ushtarak dhe ish-ushtarak, por padyshim edhe ndaj të tjerëve, sepse, siç e dini, ai është në shërbim të të gjithë komunitetit. Ama, e ritheksoj që brenda këtyre hapësirave, që janë të hapura edhe për komunitetin, padyshim edhe për ushtarakët dhe ish-ushtarakët, ne po krijojmë dy kapacitete, po flas tani me terminologjinë ushtarake, të dedikuara për ushtarakët dhe ish-ushtarakët, laboratorin modern të analizave mjekësore (mikrobiologjike) dhe laboratorin dentar.

Shtruat pyetje edhe për sa i përket realizimit buxhetor të këtij viti, pra për shpenzimet në buxhetin e këtij viti. Deri tani, kur kanë mbetur edhe më pak se dy muaj, 74% të buxhetit të disbursuar apo të angazhuar dhe, sipas grafikut tonë, me parashikimin tonë buxhetor në fund të vitit ne do ta realizojmë buxhetin 100%, kjo është ambicia, ky është synimi dhe ky është parashikimi ynë realist.

Sot që flasim, kemi angazhuar dhe disbursuar 74% të buxhetit të vitit 2023.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka kërkuar zoti Sinaj për pyetje.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Gjëja e parë që dua të ngre, kryetar, është: a keni parashikuar, sikur të kemi rastin të bëjmë ndonjë mbledhje me dyer të mbyllura, si do ta zhvillojmë? Sepse të bësh mbledhje të Komisionit të Sigurisë *online* dhe opozita të mbajë atë qëndrim, duke bllokuar dyert e komisioneve, po sikur sot të kishim në diskutim një çështje sekrete dhe të na duhej të mbyllnim dyert dhe të ishim me certifikata sigurie, ku do ta bënim mbledhjen? A e mendoni, zoti kryetar, këtë gjë?

Kështu që, unë do të thosha...

Nasip Naço – Pyetjen e keni për mua, apo për zotin ministër?

Vullnet Sinaj – E kam edhe për ty, se ministri është ministër, dhe për Kuvendin përgjigjeni ju atje, kështu që dua të mbani qëndrim.

Nasip Naço – Për ditën e premtë, kur do të kemi Shërbimin Informativ Shtetëror, duhet të më japë zgjidhje... *(Nuk kuptohet)*

Vullnet Sinaj – Do të kërkoja që mbledhjet e Komisionit të Sigurisë t'i zhvillojmë në sallën e komisionit, sepse mund të ketë edhe çështje që nuk mund t'i flasim hapur. Se kur i rritim investimet te forcat e luftimit, nuk i rritim kot. Nuk ka njerëz që nuk e kuptojnë këtë gjë. Është gati 50% e buxhetit, ndërkohë që mbledhjet dhe diskutimet i bëjmë *online*.

Ndaj unë si juve, po edhe ministrit, do t'ju thosha të merrni masa që të kemi një mundësi si do t'i bëjmë mbledhjet në rastin e një situatë që kërkon mbledhje me dyer të mbyllura.

Ndërkohë, zoti Ministër, në emrin tim personal dua t'ju falënderoj për punën e mirë që bëni edhe lidhur me emergjencat civile, pasi ka qenë një rast, kur ju kam telefonuar në orët e hershme të mëngjesit, në 6 të mëngjesit, mos edhe më shpejt, më jeni përgjigjur dhe, falë përgjigjes suaj, në zonën ku kishte rënë zjarr, shpëtuan disa familje pa u djegur, disa shtëpi pa u djegur, nga ndërhyrja e helikopterit, duke ditur edhe kushtet e vështira...

Është shumë e vështirë t'i përballosh situatat e emergjencës në Shqipëri me zjarret në kohën e verës, por unë dua t'ju falënderoj në emër të atyre banorëve, si deputet, që vetë si ministër ishit në krye të detyrës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do të qëndroj pak tek emergjencat civile.

Ne si vend kemi lumenj dhe korrozion nga të gjitha anët, sidomos koha me shira krijon probleme, kemi verë të nxehtë dhe gjatë saj vuajmë nga zjarret. A keni parashikuar te ky buxhet, lidhur me emergjencat civile, masa paraprake për sinjalizimin nga zjarret?

Në fakt, unë do t'ju kërkoja një takim, t'ju vij një ditë në zyrë atje, të flasim nga afër bashkë, sepse është hera e dytë që unë ngre probleme ndaj Drejtorisë së Emergjencave Civile. Pasojat e tërmetit të vitit 2018 në Smokthinë ende nuk kanë gjetur karar në zonën time, nuk janë zgjidhur ende problemet e atyre banorëve, bashkë me problemet e tjera që do të ndodhin. Ndaj do të desha të di nga ju, a është i mjaftueshëm buxheti që keni parashikuar ndaj emergjencave civile prej 1 miliard e 910 milionë lekësh në shpenzime kapitale të trupëzuara të brendshme dhe prej 2 miliardë lekësh në shpenzime kapitale të trupëzuara të huaja, për kërkesat që ka vendi ynë me një verë të nxehtë dhe dimër me lagështirë e shira të rrëmbyeshëm?

Faleminderit dhe suksese!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Sinaj!

Po, zoti Ministër.

Niko Peleshi – Zoti Sinaj, faleminderit edhe për fjalët e mira, edhe për pyetjen!

Siç e thatë ju, po edhe unë në fjalën time, ne jemi një vend i ekspozuar përgjatë gjithë stinëve ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile që burojnë prej tyre.

Ju, me të drejtë, e filluat pyetjen nga përmirësimi i sinjalizimit të hershëm, sepse një pjesë e madhe e dëmit mund të eliminohej nëse ne do të kishim sinjalizim në kohë. Asnjë zjarr nuk do të mund të arrinte të merrte një pyll të tërë, po themi, nëse do të sinjalizoheshim herët, madje jo thjesht ne, por komuniteti dhe pushteti vendor, sepse ata e kanë në administrim dhe në përgjegjësi territorin.

Pra, një vatër zjarri, nëse kapet shpejt, do të mund të eliminohej edhe me kapacitetet më modeste të një bashkie.

Çështja është që ky sistem, gjë e cila ka lidhje edhe me ndërgjegjësimin e komunitetit, me një rol të shtuar të kryepleqve të fshatrave, me një funksionim më të mirë të strukturave vendore, nëse do të funksiononte në mënyrë perfekte, ne do ta eliminonim pjesën më të madhe të emergjencave.

Megjithatë, pozitive është që nga viti në vit, e përmenda edhe më lart, rritet ndërgjegjësimi, rritet aftësia reaguese, rriten edhe ndërgjegjësimi i komunitetit dhe sinjalizimi i hershëm. Ndaj,

edhe po të shohim grafikët, ndonëse kemi gjithnjë e më shumë vatra zjarri, për shembull, kemi gjithnjë e më pak sipërfaqe të djegura. Kjo tregon punën e mirë dhe mirëfunksionimin e sistemit.

Çfarë po bëjmë ne, përveç aktiviteteve sensibilizuese, për të nxitur dhe për ta përmirësuar sinjalizimin e hershëm? Vazhdon puna dhe takimet me kryetarët e bashkive, me prefektët, bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme (pra, ndërmjet Forcave të Armatosura dhe Policisë së Shtetit), si dhe gjithë strukturave të tjera.

Ne, gjithashtu, po përdorim edhe teknologjinë, edhe imazherinë, por së shpejti do të kemi imazheri edhe më të saktë, edhe më në kohë reale përmes dronëve. Ama, do të kemi edhe përpunimin, sepse imazheria është njëra gjë, por përpunimi, rezultatet dhe ndërtimi i politikave të bazuara mbi *data* (mbi të dhënat e teknologjisë) janë një gjë tjetër.

Ne tani po ngremë edhe kapacitetet tona, po edhe në bashkëpunim me ASIC-un, edhe me Qendrën tonë të Informacionit, e cila do të hapet së shpejti, do të kemi në fokus të punës përpunimin e të dhënave që marrim nga teknologjia dhe kthimin e tyre në plane pune e në politika më të mira për të përballuar emergjencat.

Pra, nëse ne arrijmë ta realizojmë të gjithë gjurmën dhe ecurinë e një vatre zjarri me teknologjinë e sapopërmendur, vitin pasues ne do të dimë më mirë si, çfarë dhe cila është mënyra më e mirë për të bërë më shumë me më pak, në mënyrë që me burimet që kemi në dispozicion të kemi më shumë impakt. Ky vit do të jetë shumë pozitiv për emergjencat civile, për të gjithë sistemin e mbrojtjes civile, sepse disa programe, edhe me financim të huaj, do të marrin jetë. Kredia italiane prej 31 milionë eurosh, për të cilën ne e kemi mbaruar pjesën tonë, por ka pasur një lloj vonese, me thënë të vërtetën, sa i përket përgjigjes nga pala italiane, për shkak të mirëkuptimit dhe procedurave që duhet me patjetër të kalohen, pra për kredinë në fjalë presim që shumë shpejt të marrim dritën jeshile, ta ratifikojmë në parlament dhe ta aktivizojmë në muajt e parë të vitit që vjen. Kjo kredi do të fuqizojë kapacitetet kryesisht në nivel vendor me mjete zjarrfikëse dhe mjete të tjera të nevojshme për mbrojtjen civile. Kemi, gjithashtu, një fond. Natyrisht, asnjëherë nuk është i mjaftueshëm, sidomos në çështjet që lidhen me fatkeqësitë natyrore që nuk i dimë, mund të parashikojmë vetëm një pjesë të tyre duke u bazuar te statistikat e viteve të kaluara, por ka gjithmonë të papritura. Ndaj buxhetet asnjëherë nuk mjaftojnë, por këtë vit ne kemi, siç e thatë ju, 1,9 miliardë në financimin e brendshëm, kemi afro 1 miliard të tjera (por 800 milionë lekë), që janë shpenzime korrente, transferta për buxhetet e bashkive.

Nëse e keni parasysh, ne e ndajmë mbështetjen për bashkitë në dy-tri forma, ku njëra formë është mbështetja buxhetore. Në proporcion me peshën specifike të buxhetit të çdo bashkie mbi totalin e buxhetit të pushtetit vendor, ne japim edhe transfertën buxhetore të dedikuar për dëmshpërblime dhe investime në fushën e përmirësimit të sistemit të mbrojtjes civile.

Nga ana tjetër, kemi edhe një zë të veçantë, i cili funksionon mbi bazën e projekteve, pra një fond konkurrues, për projekte në parandalimin e përmbytjeve apo emergjencave të tjera natyrore, civile për bashkitë. Bashkia që sjell projektin më të mirë, jo vetëm në kuptimin cilësor, po edhe në kuptimin e përjasjes ose të kompatibilitetit me drejtimit që ne përcaktojmë si më të rëndësishme, është edhe bashkia fituese.

Kemi çdo vit 10, 15, 20 bashki, pra një përqindje e madhe e bashkive marrin edhe nga ky fond, ku, përveç transfertës që u shkon në buxhet, marrin edhe fondin shtesë që financon projektet e tyre. Këtë vit, më duhet ta them, madje këtë gjë e kërkoja edhe në fillim, sepse na duhet të bëjmë një detajim: nga fondi prej 1,9-milionësh, 0,9 do të shkojë për rezervat... Kërkoj mirëkuptimin tuaj që ta detajojmë te zëri i rezervave të shtetit, atyre materiale dhe ushqimore, padyshim të lidhur me përmbytjet, se është pjesë e tyre, pasi, kur kemi një emergjencë, një përmbytje apo një emergjencë tjetër, ka edhe pasoja, dëme në të mirat materiale, në pasurinë e familjarëve dhe të komunitetit që duhen kompensuar, sado që nevojën për të pasur rezerva e kemi qoftë edhe për të përballuar situata emergjencash lokale, rajonale, larg qoftë edhe kombëtare. Ndaj do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që nga fondi 1,9 miliardë 0,9 miliardë t'i çojmë për rezervat, kurse fondi 1 miliard do të kushtëzohet që 50% e tij të shkojë për projektet fituese të bashkive, por me drejtimin e mbrojtjes, të përmirësimit dhe përforcimit të digave.

Kemi rreth 600 rezervuarë që sot janë në administrim të bashkive, por një pjesë e madhe e bashkive nuk i kanë prioritet dhe në vëmendje rezervuarët. Duket si një investim i padukshëm, që nuk ka duk në raport me atë që një kryetar bashkie do të dojë t'i ofrojë komunitetit, por nga ana tjetër parandalon një katastrofë, që mund të ketë pasoja shumë të mëdha në varësi edhe të pozicionit apo madhësisë së një rezervuari. Kemi edhe rezervuarë shumë të rrezikshëm, që kanë nevojë për investime në përforcimin e digave, ndaj ne do ta bëjmë pak me detyrim përcaktim këtë herë. Një fond rreth 500 milionë lekë apo 5 milionë dollarë është i përcaktuar edhe në buxhet (tani është edhe detyrim buxhetor për ne), për ta specifikuar për projekte në përforcimin e digave të rezervuarve. Pra, do të jetë i dedikuar vetëm për ato projekte. Pjesa e mbetur nga ky fond (do të bëjmë llogaritë sa është) do të shkojë për projekte të tjera gjithmonë në parandalim të përmbytjeve.

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Ministër!

Duke qenë se nuk ka më pyetje të tjera, do të bëj unë dy-tri pyetje.

Niko Peleshi - Zoti kryetar, më fal, por dua të them edhe një fjali që lidhet me pyetjen e parë të zotit Sinaj për sinjalizimin e hershëm. Po investojmë në një sistem *software* për parandalimin e hershëm me vlerë 120 milionë lekë, që plotëson atë tablo të masave që ne kemi marrë për parandalimin e hershëm. Pra, krahas ndërgjegjësimit, teknologjisë, imazherisë dhe teknologjisë së inteligjencës artificiale, ne po investojmë edhe në një *soft* për sinjalizimin e hershëm me vlerë 120 milionë lekë.

Faleminderit!

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Sinaj!

Faleminderit, zoti Ministër!

Do të bëj edhe unë dy-tri pyetje.

E para, edhe pse po miratohet buxheti me 2% të GDP-së, ka vështirësi në rekrutimin e ushtarëve apo edhe ata që janë duan të largohen nga ushtria. A keni parashikuar rritje të pagave për vitin 2024, duke i krahasuar ato me vendet e tjera të rajonit, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Slloveninë, Malin e Zi dhe Kroacinë? Pra, a keni një tabelë pagash, për të ditur edhe nivelin e tyre?

E dyta, a është i mjaftueshëm buxheti për vitin 2024, zoti Ministër, ndërkohë që kam parasysh që vendet e tjera të rajonit kanë një buxhet tejet të madh? Serbia e ka 1,4 milionë dollarë buxhetin për vitin 2024, Sllovenia e ka 2,2 milionë dollarë, Kosova e ka 153 milionë dollarë, Maqedonia e Veriut e ka 274 milionë dollarë. A është i mjaftueshëm ky buxhet, duke e krahasuar me situatën në rajon?

Pyetja e tretë ka të bëjë me industrinë ushtarake, që e përmendën edhe kolegët e tjerë gjatë pyetjeve. Çfarë parashikon Ministria e Mbrojtjes për rivënien në punë të industrisë ushtarake, ndërkohë që vende të tjera në rajon kanë fitime nga industria ushtarake? Bosnjë-Hercegovina ka një fitim vjetor prej 30-40 milionë eurosh, Serbia 350 milionë euro, Bullgaria 1,7 miliardë euro, kurse ne e kemi në konservim. Çfarë ka parashikuar ministria? Unë nuk pretendoj që Ministria e Mbrojtjes, industria ushtarake, të prodhojë dronë, është tej imagjinatës sime, por të paktën të vihet në punë ajo industri, qoftë edhe modeste, për prodhimin e fishekëve?

Pyetja tjetër ka të bëjë edhe me kërkesën që kam bërë për interpelancë, zoti Ministër, për ish-kombinatit mekanik të Poliçanit, që e përmendën edhe dy kolegët e tjerë, zoti Mahmutaj dhe

zoti Kollçaku. Si do të vazhdojë ky problem, edhe pse projektligjin ju e keni bërë? Ju thatë se është një precedent për raste të tjera dhe mund ta kërkojnë edhe të tjerët. Zoti Ministër, ju e keni një precedent. Qeveria shqiptare ka miratuar me tri vendime qeverie dhënien e pagës për 3 vjet rresht të punonjësve të rafinerisë së naftës në Ballsh, e cila është e privatizuar. Nuk kam asnjë kundërshtim, mundësisht t'u jepet përsëri, por kur ua keni dhënë pagën atyre punonjësve, duhet t'ua jepni edhe punonjësve të ish-kombinatit mekanik të Poliçanit për shkak të detyrimeve ligjore që keni. As e jepni me koncesion, as ia kaloni në administrim bashkisë së Poliçanit dhe as e vini në punë vetë si Ministri e Mbrojtjes, por e lini në konservim, duke parë situatën dhe rajonin.

Faleminderit, zoti Ministër!

Niko Peleshi - Faleminderit, kryetar!

Po filloj direkt me përgjigjet.

Për sa i përket problematikës së rekrutimeve dhe kërkesave për largime, nuk është shumë e lehtë që të kemi rekrutime në Forcat e Armatosura dhe kjo nuk është vetëm sfidë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, por sidomos pas pandemisë është edhe një lloj tendence globale që të rinjtë nuk para preferojnë, për fat të keq, punët e vështira.

Gjithsesi, rritja shumë e madhe, deri dhe historike, e pagave vitin e kaluar deri në 40% për të gjithë ushtarakët, nga ushtari bazë deri te gradat e larta, i ka bërë më atraktive Forcat e Armatosura dhe na e ka lehtësuar punën për rekrutimet. Nuk jemi akoma të kënaqur me rezultatet, por duhet thënë që jemi shumë të kënaqur me rezultatet e rekrutimeve të kadetëve, studentëve, në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Po ju jap vetëm një shifër që na bën optimistë. Këtë vit ne hapëm 60 kuota në Akademinë e Forcave të Armatosura. Fillimisht patëm 980 aplikime për 60 pozicione në Akademinë e Forcave të Armatosura. Pra, patëm 15 herë më shumë kërkesa sesa kemi kuota në Akademi. Kjo tregon rritjen e interesit të të rinjve për t'iu bashkuar Forcave të Armatosura dhe është një rritje cilësore, sepse i bashkohen edhe si oficerë potencialë. Pra, është një prurje kualitative. Këta të rinj vijnë nga e gjithë Shqipëria. Edhe nga Kosova kemi 10 studentë, të cilët edukohen, shkollohen këtu, dalin me dije shqiptare, të doktrinës sonë, i bashkëngjiten Forcave të Armatosura dhe, padyshim, pastaj i shoqëron një karrierë e garantuar në Forcat e Armatosura. Ne kemi mundësi të shumta për t'i trajnuar në vazhdimësi, për t'i kualifikuar dhe rritur në karrierë ushtarakët tanë, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vendet e ndryshme të Bashkimit Europian, në qendra të ekselencës. Siç e thashë, nuk kemi vetëm *bachelor*-in e shkencave sociale,

por edhe të teknologjisë së informacionit dhe të marrëdhënieve të komunikimit. Pra, ka mundësi të jashtëzakonshme, të cilat duhet t'i promovojmë më mirë. Rekrutimi lidhet jo vetëm me realitetin e pagesave dhe të kushteve të trajtimit në stërvitje apo të kushteve të trajtimit social të ushtarakëve tanë, por edhe me marketingun. Besoj e keni vënë re që ka ndryshuar si nata me ditën me të kaluarën mënyra se si ne u afrohem të rinjve tanë në stinën e rekrutimeve në qendër të Tiranës. Në kilometrin zero ne vendosim qendrën tonë mobile të rekrutimit, ku gjatë gjithë ditës të rinj dhe të reja, vajza dhe djem ushtarakë, janë të gatshëm të komunikojnë me të rinjtë e tjerë që shkojnë për të vizituar këto qendra, për t'u treguar atyre çfarë janë Forcat e Armatosura dhe çfarë ne bëjmë çdo ditë dhe sa dinjitoze është të jesh pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Padyshim, përveç anës morale, është edhe ana materiale, që është gjithmonë duke u bërë më e mirë. Krahas pagës, që është rritur me 40%, ne japim edhe trajtim ushqimor rreth 100 mijë lekë të vjetra në muaj për çdo ushtarak. Kadetët tanë, studentët, që ditën e parë kur fillojnë Akademinë e Forcave të Armatosura marrin pagesë. Jo vetëm që nuk paguajnë për akomodim, për ushqim, sepse i kanë falas, por marrin edhe pagesën e ushtarit. Pra, futen në rrogë që ditën e parë të shkollës dhe derisa vazhdojnë karrierën e tyre në Forcat e Armatosura. Rritja e pagave është pjesë edhe në buxhetin e vitit 2024. Do të kemi rritje të pagave nga 7-22%. Rritja e pagave këtë vit do të synojë të rrisë më shumë pagat e ushtarëve dhe gradave më të ulëta. Në gradat më të larta ne jemi edhe më mirë se disa vende në rajon, meqenëse më pyetët si jemi në krahasim me vendet e rajonit, por duhet të bëjmë përmirësim të pagave më të ulëta, kjo për të shkuar drejt objektivit që të jemi në mesataren e vendeve aleate dhe në më të mirën e rajonit tonë. Për sa i përket pyetjes nëse buxheti mjafton, jo vetëm për sigurinë dhe mbrojtjen, por për çdo sektor buxheti nuk mjafton asnjëherë. Siç e thashë edhe në fillim, të gjitha shtetet, sado të zhvilluara të jenë, sado të pasura të jenë, kanë gjithmonë më shumë nevoja sesa mundësi, por duhet thënë që buxheti i vitit 2024 ka një rritje shumë të madhe edhe për shkak të sforcos. Duhet ta themi që është një sforcë e madhe buxhetore për qeverinë e Shqipërisë për të arritur përmbushjen e angazhimit tonë prej 2% të GDP-së në raport me angazhimin tonë në NATO. Kjo sforcë buxhetore natyrisht na pakëson burimet në vende të tjera, në projekte të tjera të sektorëve të tjerë që kanë nevojë për financim, por nga ana tjetër na jep një prestigj dhe reputacion shumë pozitiv në raport me aleancën tonë në NATO. Ne jemi jo vetëm krenarë, por edhe fatlumë që jemi pjesë e kësaj Aleance, sidomos në këto kohë të vështira, kur siguria dhe mbrojtja është bërë kaq e tronditur dhe kaq e brishtë. Për sa i përket industrisë ushtarake, nuk është për t'u mburrur që nuk kemi industri ushtarake. Para pak vitesh

mendonim që nuk do të kthehej dita kur të na duhej të militarizoheshim, pra, demilitarizimi ishte kryefjalë në mjediset tona, kurse tani ka ardhur momenti që duhet ta rikthejmë, rizgjojmë, risjellim, rivitalizojmë industrinë ushtarake. Natyrisht, kërkohen operatorë profesionistë dhe nuk mund ta bëjë një institucion shtetëror si Ministria e Mbrojtjes, sepse nuk bëhet fjalë për të punuar vetëm për tregun vendas, por edhe për eksport në tregun e huaj. Po e qasim duke qenë sa më të hapur dhe sa më promovues. Edhe në takimet dhe forumet e industrisë ushtarake në kuadrin e NATO-s ne marrim pjesë, ndonëse nuk kemi industri ushtarake të mirëfilltë, për të tërhequr investitorë. Shpeshherë në fjalën time në ministerialet e NATO-s unë e kam bërë ftesën për investitorë nga vende të tjera që të investojnë këtu. Kemi vazhdimisht vizita. Tani jemi proaktive, sepse kemi një material të besueshëm dhe shumë serioz nga Agjencia e Prokurimeve të NATO-s, NSPA-ja, një diskutim parafizibilitetit, që na tregon çfarë kemi, sa vlerë ka, cili është potenciali dhe sa para do të duheshin për ta risjellë në jetë aktivitetin e industrisë tonë ushtarake: Poliçanin Mjekësin dhe Gramshin.

Pyetja e fundit ka lidhje me detyrimet e ish-kombinatit mekanik të Poliçanit, kemi hartuar ligjin, e kemi në proces. Ju përmendët precedentin, unë i jap të drejtë Ministrisë së Financave që e tërheq atë vërejtje, ose atë kujtesë të krijimit të një precedenti, të pagimit të detyrimeve të ndërmarrjeve shtetërore nga shteti, gjë që ligji nuk e lejon, por vetëm me ligj të veçantë mund të bëhet e mundur. Nga njëra anë i jap të drejtë Ministrisë së Financave, por nga ana tjetër, jam gati të shpjegoj, edhe ia kam shpjeguar me anë të shkresave Ministrisë së Financave, siç po jua shpjegoj edhe juve tani, arsyet pse detyrimet e ish-Kombinatit Mekanik të Poliçanit meritojnë të paguheshin me listë të veçantë nga buxheti i shtetit, për shkak të sensibilitetit që ky ka sektor, për shkak se duam të tërheqim aty sa më shpejt të jetë e mundur investime serioze vendase apo të huaja, apo operatorë kryesisht të huaj me eksperiencë në këtë fushë, në mënyrë që ta kthejnë dhe në ekonomi, pra si vendet e tjera të sjellim të ardhura për ekonominë shqiptare për buxhetin e shtetit. Pra, ia vlen për ta pasur sa më të shëndetshme atmosferën aty, që të mos e mbajmë të ngarkuar me aq shumë detyrime atë ndërmarrje shtetërore, e cila pastaj do t'ia ulte vlerën, atraktivitetin në raport me investitorët e huaj, por ta shkarkojmë sa më shumë të jetë e mundur. Pse them, sa më shumë të jetë e mundur? Sepse ne nuk mund të marrim përsipër të paguajmë çdo lloj detyrimi edhe vendime gjyqi, gjykatash të fituara nga (nuk dua t'i paragjykoj) punëtorët apo ish-punëtorët, pro ne do të paguajmë pagat e sigurimeve shoqërore në vlerën prej 850 mijë dollarë për punëtorët e Poliçanit. Detyrimet e tjera pastaj, siç edhe ligji e thotë, nuk janë detyrime tona, por do të ngelen detyrime

të kombinatit. Çdo të thotë kjo? Kjo do të thotë se nëse do të kemi sukses për të tërhequr investime dhe për rivitalizuar ish-Kombinatit Mekanik të Poliçanin, natyrisht investitori do ta marrë këtë kombinat, këtë aset me të mirat dhe me të këqijat, pra edhe me detyrimet që ai ka. Ato merren përsipër nga operatorët, nga investitorët potencialë që, me shumë shpresë, do të afrojmë atje. Pra, nuk janë detyrime që do të paguhen të gjitha nga ne. Ne do të paguajmë pagat dhe sigurimet shoqërore dhe ato që ngelen nuk janë detyrime që nuk do të paguhen kurrë, por do të paguhen ditën kur ai kombinat do të vendoset në punë.

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Ministër!

Si kryetar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare jam tejet i kënaqur, si deputet i qarkut të Beratit jam pjesërisht.

Fjala është për zonjën Resulaj.

Pranvera Resulaj – Më dëgjon kryetar?

Nasip Naço - Po. Pyetje, pastaj komentet

Pranvera Resulaj – Në fakt, ju përpiqeni gjithmonë të na disiplinoni, por unë po vrisja mendjen si ta bëj një pyetje që të mos ta ketë përgjigjen brenda.

Zoti Ministër, faleminderit!

Çfarë do të thotë: “objektivi i NATO-s 2% të GDP-së për mbrojtjen”? Praktikisht, NATO-ja pret nga ne që të shtojmë kapacitetet tona, por lidhur me detyrimet dhe angazhimet tona në Aleancë, a do të kemi një rritje me kosto financiare të këtyre angazhimeve?

Diçka më tepër për të sqaruar, për mua si deputet, por edhe për opinionin publik.

Nasip Naço - Faleminderit, zonja Resulaj!

Po, zoti Ministër!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Kur themi: “Buxheti mbrojtjes duhet të jetë sa 2% e GDP-së”, nuk do të thotë se 2% e GDP-së duhet paguar për NATO-n. Jo, nuk funksion kështu. NATO-ja kërkon që vendet anëtare të investojnë, së paku, 2% të GDP-së si buxhet për sigurinë dhe mbrojtjen. I ndarë në dy shtylla, buxheti i sigurisë dhe i mbrojtjes, do të thotë: objektiva të kapaciteteve të NATO-s, pra kërkesa apo angazhime në raport me nevojat e NATO-s si aleancë, natyrisht, brenda vendit tonë dhe objektivat tona kombëtare. Pra, disa kapacitet tona kombëtare janë kapacitete që edhe NATO-ja i ka në llogarinë e saj, pra janë kërkesa të NATO-s për t’i ngritur si kapacitete.

Për shembull, unë përmendsha pak më lart edhe një anije patrulluese, që është një nga objektivat tona. Deri në vitin 2018 ne duhet ta bëjmë këtë investim, që nuk është një investim i vogël, shkon nga 70 deri në 100 milionë dollarë, pak a shumë. Nuk është në buxhetin e këtij viti, por deri në vitin 2028, për shembull, ne jemi angazhuar në NATO që do ta kemi këtë kapacitet. Pra, ky është një nga objektivat e kapaciteteve të vendit tonë në raport e NATO-n. Ne kemi vendosur diçka në buxhetin e këtij viti, pra do të fillojmë me përgatitjen e projektit, miratimin e tij, të këtij projekti ushtarak, dhe dalëngadalë do të fillojmë ta buxhetojmë dhe ta realizojmë. Do të jetë kapaciteti ynë, por llogaritet si përmbushje e një angazhimi që kemi marrë në NATO. Veç këtyre angazhimeve, çdo shtet ka angazhimet e tij kombëtare, forcon mbrojtjen kombëtare në ato komponentë dhe dimensione ku e vlerëson vetë në përgjigje edhe të kërcënimeve të identifikuar. Për shembull, kërcënimet nga sulmet kibernetike, siç ishte rasti i sulmeve të orkestruara nga shteti i Iranit. Ky është një objektiv në raport me NATO-n, ky është një objektiv në raport me kapacitet tona kombëtare, të cilat koha na tregoi se ne duhet t'i ngremë, duhet t'i kemi në fokus dhe duhet t'i kemi prioritet. Ka shumë dinamikë edhe situata e sigurisë, edhe natyra e kërcënimeve në kohën e sotme, ecin paralel edhe me ndryshimet teknologjike. Pra, ne investojmë në kapacitetet e brendshme, por që janë të kërkuara, të angazhuara në NATO, investojmë edhe në kapacitete të brendshme, të cilat ia kemi kërkuar ne vetes, si më thënë i kemi vënë detyra kombëtare, për shkak se e vlerësojmë si përgjigje ndaj kërcënimeve të mundshme. Kështu shpërndahet ky buxhet, i cili është sa 2% e GDP-së, pra plotëson këtë angazhim në raport me NATO-n dhe, nga ana tjetër, furnizon ngritje kapacitetesh në të gjitha dimensionet dhe *domain*-et tona tokë, ajër, det, por ne tani kemi edhe *domain*-in e sigurisë kibernetike. Në mënyrë modeste, por jemi edhe në *domain*-in e pestë, që është *domain*-i i hapësirës, sepse dy satelitë na shërbejnë në mënyrë të dedikuar me imazhe satelitore. Është, si të thuash, një fillesë e përdorimit apo e futjes edhe në këtë *domain* të pestë. Pestë janë *domain*-et: toka, ajri, deti, mbrojtja kibernetike dhe ajo hapësinore. Detyrimi tjetër është që rreth 20% e këtij buxheti të shkojë për modernizimin, ky është edhe një synim tjetër, ndaj për të plotësor këtë kusht, gjithnjë dhe më tepër, nga viti në vit, ne po i rrisim investimet tona në drejtim të modernizimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve të tjera të forcave tona. Faleminderit!

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Mahmutaj, kishit për të diskutuar? Sepse nga kolegët e tjetër të mazhorancës asnjëri nuk ka zgjedhur të diskutojë.

Zoti Mahmutaj, më dëgjon?

Kasëm Mahmutaj – Më dëgjoni tani besoj?

Nasip Naço – Po.

Kasëm Mahmutaj – Nuk dua t'ju ha kohën, edhe ministri i tha të gjitha për buxhetin, por dua të them që duhen pasur në qendër të vëmendjes, ato që u diskutuan, zjarret, tërmetet, emergjencat civile. Rëndësi duhet t'i japim për kohën, për situatën, mbrojtjes nga përmbytjet. Nuk e di, duhet të kenë projekte dhe plane afatgjata për sa u përket qyteteve Vlorë, Durrës Shkodër, Lezhë, bregdeti në përgjithësi. Nga ky buxhet, nga 2%-shi, sa është parashikuar që të kalojë për projektet afatgjata të mbrojtjes civile?

Nasip Naço - Zoti Mahmutaj, jo pyetje, sepse i kemi kaluar pyetjet.

Nëse keni diskutim...

Kasëm Mahmutaj – Të kuptova shumë mirë.

Shumë faleminderit!

Nasip Naço – Zoti Ministër, përgjigja juaj për pyetjen.

Niko Peleshi – Buxheti total i mbrojtjes civile është 5,4 miliardë lekë. 1 miliardë, 800 milionë lekë ekzaktësisht do të shkojnë si mbështetje buxhetore për bashkitë me kushtin që të përdoren për dëmshpërblime dhe përballim emergjencash. Ne do ta sjellim me shkresë kërkesën për një rishikim të detajimit për 1,9 miliardë lekë, që do të ndahen, ku 0,9 miliardë lekë do të shkojnë për rezervat material ushqimore dhe 1 miliardëshi tjetër do të jetë fond për bashkitë, që u delegohet bashkive, por mbi bazën e projekteve konkurruese, fituese. Projektet që fitojnë, në kuadër të parandalimit të pasojave të fatkeqësive natyrore, dërgohen pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, vlerësohen nga komisioni përkatës aty, shpallen fituesit dhe pastaj u alokohet fondi, u delegohet fondi që vetë bashkitë e prokurojnë dhe e zbatojnë. Fondi prej 1 miliardë lekësh do të ketë edhe një kusht tjetër brenda, pra jo vetëm që do të jetë i dedikuar bashkive për investime me projekt fitues, konkurrues, por 50% e këtij fondi, rreth 5 milionë dollarë do të jenë të dedikuara për projekte në forcimin e digave të rezervuarëve. Do të jetë me kusht, nuk do të jetë një fond i hapur për gjithçka. Gjysma e fondit, që do të thotë 5 milionë dollarë, do të jenë të dedikuara për këto projekte, prandaj do t'u kërkojmë bashkive që kanë rezervuarë (të gjitha kanë rezervuarë) të hartojnë projekte për përforcimin e digave dhe të aplikojnë, përndryshe ky fond nuk mund të shkojë në destinacion tjetër. Pjesa e mbetur e këtij fondi, që janë rreth 5 milionë dollarë të tjera, do të jenë të hapura për natyra të ndryshme të projekteve të parandalimit. Bashkitë tuaja, nëse unë do të isha deputet (siç jam, por, në fakt, i një zone tjetër) i zonave që janë më të kërcënuara, unë do të

inkurajoja kryetarët e bashkive të aplikojnë në kohë dhe me cilësi me projekte për parandalimin e përmytjeve, për shembull, apo të rrëshqitjeve, apo të erozioneve të caktuar, të të gjitha natyrave më kritike të fatkeqësive natyrore. Sa më i mirë të jetë projekti, aq më shumë mundësi ka për t'u fituar. Siç e thashë, çdo vit, ne kemi mbështetur nga 11, 15, 20 bashki. Pra, rreth 1/3 -1/4 e bashkive kanë përfituar nga ky fond, përveç fondit që shkon si mbështetje buxhetore për 100% të bashkive. Çdo bashki merr një buxhet nga Ministria e Mbrojtjes, në raport me madhësinë që ka si bashki, të dedikuar për ta përdorur për dëmshpërblime dhe investime të tjera, për shembull, për të blerë zjarrfikëse, për të blerë borëpastruese apo mjete të tjera, apo për të ndërtuar një urë apo këmbët e urës, të cilat pastaj i plotëson Ministria e Mbrojtjes me urën *bailey* e të tjera.

Në total ne kemi 5,4 miliardë lekë për të gjithë sistemin e mbrojtjes civile.

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit, të nderuar kolegë për durimin, për pyetjet, sugjerimet dhe për mbështetjen!

Besoj se dhe në emrin tuaj vota jonë është pro për buxhetin. Faleminderit, zoti Ministër!

Ka qenë një nga prezantimet më të mira në këta 3 vjet në Komisionin e Sigurisë, besoj se flas edhe në emër të kolegëve. Si kryetar i komisionit ju mbështes maksimalisht, por si deputet i qarkut të Beratit kam rezerva dhe kemi një llogari të hapur. Ju faleminderit!

Vullnet Sinaj – Kryetar, a ka mundësi vetëm një sekondë?

Kasëmin e falënderoi njeri që është në mbledhje? A do vijë prapë me ne?

Nasip Naço - Ai e ka detyrim.

Vullnet Sinaj – Kasëm, komplimente nga ana ime!

Nasip Naço - Ai është deputet i opozitës, është i lirë dhe voton si europian.

Faleminderit, për ndërhyrjen!

Faleminderit, zoti Ministër!

MBYLLET MBLEDHJA